

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7678 E shtunë 13 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i **Ditës**

Pak ditë më parë, gazetari Ervis Iljazaj komentoi në median e shkruar nismën e fundit në arsim: ngritjen dhe funksionimin e asaj që po quhet ...

Vijon në faqen 20


Nga PËLLUMB KARAMETA

Mësuesi i diplomuar në Oxford dhe shkolla e drejtorëve



Dje në "Deutsche Welle"


Para pikërisht 50 vjetësh, më 12 tetor 1968 Republika Federale Gjermane nënshkroi Marrëveshjen për Tërheqjen e Fuqisë Punëtore me Jugosllavinë ...



Vijon në faqen 21

Nga MARINA MARTINOVIC

Gjermani-Jugosllavi, ata që qëndruan një jetë



"Erjona Parruca, gruaja ime e jetës"

Letra e plotë e Zet Haxhisë: Ja kush po na sulmon, do hap 'kutinë e Pandorës'

Mesazhi për "News 24" nga burgu 302: Ja çfarë di për Azemin, Berishën e Haklajt

Zet Haxhia, truproja e parë e ish-kryeministrit Berisha, në një letër të dërguar në redaksinë e televizionit "News 24", bën të ditur faktin se avokati e ka braktisur prej 2 muajsh, asnjë prokuror nuk ka shkruar ta marrë në pyetje, ndërsa për herë të parë akuzon vëllain e tij, Ismet Haxhinë dhe Romeo Karajn se po sabotojnë çështjen ...

Në faqen 7

KRYEMINISTRI: BOLL ME DEBATE TELEVIZIVE TE SAJUARA, TANI NE GJYKATE

RAMA: PAKETE ANTISHPIFJE, PADI PER KAZANIN MEDIATIK

Kreu i qeverisë shpërthen ndaj kritikëve: Kazanpolitikë, kazanmedia, shpifës, baltë, neveri që helmon Shqipërinë, zhurmë e fabrikës së baltës



(Në foto) Kryeministri Edi Rama gjatë një konference shtypi

Në faqen 3

OPOZITA

Basha, Edi Ramës: Nuk më tremb dot. Monika Kryemadhi: Pushteti ka rënë

Në faqen 2

DESHMIA

Vrau 3 veta në Mat, autori në polici: Ata më fyen dhe më qëlluan me shuplakë

Në faqen 9

TAKIMI

Rama me Makronin në Armeni: Presidenti francez do të vizitojë Tiranën

Në faqen 3

PERGJIMI ME XHAFAJN

Lirohet "Babalija" në Kosovë: Kam frikë të kthehem në Shqipëri

Në faqen 3

FLET EKSPERTI



Lehtësirat në ligjin e ri, Fatos Malaj: Si të merrni nënshtetësinë greke

Në faqen 11

BLUE TOOTH Tentuan ta vrisnin, menaxheri i Ledri Vulës: Erdhën me maska, dikush ka paguar lekë

'Miss Durrësi': Sfidat e së dielës televizive

Përvjetor i veçantë, aktori i "Portokalli" feston ditëlindjen ashtu si dikur

Nga PAMELA ALIAJ

P



vjeçe. Ka ndodhur krejt rastësisht pjesëmarrja në kompeticion. Në atë kohë ishte akoma tabu pjesëmarrja dhe përzgjedhja e vajzave bëhej në shkolla. Aty më zgjodhën dhe fati deshi që të merrja pjesë dhe të fitoja. Më pas fitova përsëri vendin e parë në "Miss Beauty ...

Suplement

SKANDALI REAGIMET

Kreu i PD-së pyetet në prokurori për rastin "Xhisiela": Regjim kriminal

Basha, mesazh Ramës: S'më tremb dot dhe as nuk shantazhohem

"Më të vendosur për largimin e krimit nga politika"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, iu bind dje kërkesës së prokurorisë dhe u paraqiti në organin e akuzës së Tiranës për të dëshmuar pas kallëzimit të kreu të grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, për "kallëzim të rremë" dhe shpifje sa i përket çështjes "Xhisiela". Bashës i mjaftuan 30 minuta për të dhënë sqarime në Prokurorinë e Tiranës për kallëzimin e bërë nga socialisti Balla, por që andej doli me mesazhin e qartë se pavarësisht përpjekjeve, nuk do të mund të trembin opozitën. Në përfundim të seancës së pyetjeve, kryetari i Partisë Demokratike tha se thirrja e tij në prokurori është përpjekje për të trembur opozitën. "Dy deputetë të opozitës janë thirrur sot (dje) në prokurori; deputeti Sali i, sepse është kallëzuar nga një trafikant i dënuar droge dhe unë i kallëzuar nga një politikant bandit i lidhur me krimin. Kur regjimet e korruptuara dhe të inkriminuara janë afër fundit, faza e fundit është përdorimi i shtetit me shpresën e dëshpëruar për të mbytur zërin e opozitës dhe për të shpëtuar pushtetin e tyre të inkriminuar. Thirrja e kryetarit të opozitës në një regjim kriminal për t'u paraqitur në prokurori nuk është fundi i opozitës, por fillimi i fundit të regjimit kriminal", deklaroi kreu i PD-së. Z.Basha bëri të qartë se ai dhe opozita nuk tremben nga ato që i quan makinacione të shtetit privat të Edi Ramës. "Sot kam një mesazh të qartë për Edi Ramën dhe veglat e tij qorre në shtet, media dhe kudo: Partia Demokratike, unë dhe shqiptarët e vendosur për të larguar krimin nga politika, as nuk trembemi, as nuk shantazhohemi dhe as nuk impresionohemi nga makinacionet politike të shtetit privat të Edi Ramës, por jemi të vendosur për të vazhduar



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

Basha në prokurori, Kryemadhi: Pushteti ka rënë, do çrënjosim krimin

Kryetarja e LSI-së, Moni Boka Kryemadhi, akuzoi dje se në kohën kur krimi ka zaptuar çdo segment në vendin tonë, prokuroria thërrret të dëshmojë kreu e PD-së, Lulzim Bashën, duke lënë të "lirë" Taulant Ballën. Sipas saj, ky i fundit është i faktueshëm dukshëm si pjesëmarrës në afëra kriminale: "Në kohën kur kreu i grupit parlamentar të PS është dukshëm dhe faktueshëm i përfshirë në afëra kriminale, Arta Marku dhe Donika Prela, në shurdhësi dhe verbëri kriminale zbatojnë urdhrat e Edi Ramës, duke shënuar fundin e një shteti normal dhe duke firmosur regjimin kriminal dhe të diktaturës mafioze të tij. Ky i fundit, edhe pse në krye të prokurorisë ka kukullat e veta, sërish nuk paraqitet për t'u përballur me akuzat dhe denoncimet që opozita ka dorëzuar për të. Sepse Edi Rama u frikëso-



het jo vetëm padive të opozitës në prokurori, por edhe vetë atyre që ka emëruar atje". Ky skenar sipas Kryemadhit, tregon qartë se ky pushtet ka rënë. "Sepse asnjë shërbëtor, sado i bindur, nuk mund ta mbrojë më frymëzuesin dhe zbatuesin e kriminalitetit që po mbytet çdo strukturë funksionale të shtetit. Vajtja e kreu të opozitës në prokurori është shenja e fundit e qartë se ky pushtet ka rënë! Frika që i ka pushtuar tashmë nuk njeh më asnjë barrierë ligjore. Dhe për këtë, përgjegjësi do të mbajnë të gjithë ata që sot drejtojnë policinë dhe prokurorinë me porositë e Edi Ramës dhe të vasalëve të tij. Opozita e ka të qartë aksionin e saj për çrënjosjen e krimit dhe bandave nga drejtimi i shtetit", tha zj. Kryemadhi.

deri në fund betejën tonë për çmontimin e këtij shteti privat dhe shkatërrimin e diktaturës mafioze", u shpreh z.Basha. Në derën e prokurorisë, Basha garanoi se opozita është e vendosur për të vazhduar deri në fund bete-

jën për çmontimin e asaj që e cilëson si diktaturë mafioze. Partia Demokratike dhe kryetari i saj akuzojnë kreu e grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, se ka qenë në komisaritanje e Pushë-Kruijes kur Emiljan

MESAZHI
"Kur regjimet e inkriminuara janë afër fundit, faza e fundit është përdorimi i shtetit me shpresën e dëshpëruar për të mbytur zërin e opozitës dhe për të shpëtuar pushtetin e tyre të inkriminuar. Thirrja e kryetarit të opozitës nga një regjim kriminal për t'u paraqitur në prokurori nuk është fundi i opozitës, por fillimi i fundit të regjimit kriminal", tha z.Basha.

PETRIT VASILI
"Prokuroria nuk guxon ta thërrasë, ta pyesë, ta procedojë kryeministrin e paditur, të vetëshpallur fajtor. Prokuroria ka vendosur të jetë kundër popullit, kundër ligjit dhe kundër Kushtetutës. Dihet botërisht se ç'ndodh kur je kundër popullit dhe ligjit, dihet edhe fundi i kamikazëve. Tanimë prokuroria e zgjodhi fatin e vet", tha z.Vasili.

Nuhut i kanë vendosur pistoletë në kokë të afërmit të Rexhep Rrajës. Sipas dëshmisë së ish-oficerit, ai ishte duke marrë denoncimin e Xhisiela Malokut për dhunë nga djali i deputetit Rrahman Rrajë.



Gjatë një seance parlamentare

BUJAR NISHANI

Ish-presidenti Bujar Nishani e konsideroi si krim shtetëror thirrjen e kreu të PD, Lulzim Basha në prokurori. Nishani shprehet: "Thirrja e kryetarit të opozitës në prokurori, pse opozita denoncoi një përdhunues të lidhur me pushtetin është një krim shtetëror. Frika ndaj regjimeve nuk ringjallet dot më në Shqipëri".



Berisha: Skandal në prokurori, zhduken përgjimet e Alizotit

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje se janë zhdukur 120 faqe transkript të regjistrimeve të bisedave të dëshmitarit të rremë, Fred Alizotit me urdhër të kryeministrit Edi Rama. "Zhduken në prokurori nga Edvin Kristaq Rama dhe banda e tij kriminale 120 faqe transkripte të regjistrimeve të bisedave të dëshmitarit të rremë Fred Alizoti, të cilat sipas OPGJ dixhitale implikonin direkt në krimin e shëmtuar të manipulimit të kallp dëshmitarit, mafiozët Rama, Xhafaj, Balla, Geron Veliu", shkruan Berisha. Sipas tij, faqet që mungojnë janë vjedhur nga mercenarët e bandës kriminale, që sipas tij, janë bërë me urdhër të kryeministrit Rama për t'i shpëtuar demaskimit. "Faqet që mungojnë në numër rendor të faqeve të transkriptuara janë vjedhur nga mercenarë të bandës kriminale të qeverisë për t'i shpëtuar nga demaskimi i plotë i implikimit të tyre në manipulimin e dëshmitarit të rremë Alizoti. Rikujtojt këtu se operacionet e vjedhjes së dosjeve të dokumenteve top-sekret, madje edhe të gjithë serverit filluan me Prokurorinë e Durësit fill pasi Edvin Kristaq Rama u shpall krye bandit i narkoshtetit", nënvizon ai. Berisha iu bën thirrje qytetarëve shqiptarë që të luftojnë fuqimisht për të larguar nga pushteti qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama.

GRIDA DUMA

"Në një kohë që policia e Fatmir Xhafajit është ngritur e gjitha në këmbë për të mbrojtur vëllain e tij trafikant droge, Shqipëria është zhytur në kaos dhe kriminalitet. Krimi godet çdo orë në çdo skaj të Shqipërisë", tha zj.Duma.



TAKIMI ME MAKRON

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka zhvilluar një takim me Presidentin e Francës, Emanuel Macron gjatë qëndrimit në Armeni. Ky i fundit pritet të vizitojë Shqipërinë, ndërsa në takim u theksua fakti se dy vendet do të vijojnë bashkëpunimin në fusha të ndryshme, me qëllim përfundimin e qytetarëve të të dyja shteteve përmes veprimtarive të ndryshme. "Me Presidentin Macron, për bashkëpunimin dypalësh dhe vizitën e tij të pritshme në Tiranë", shkroi dje Rama.



"Babalja", Saliianji në prokurori: Videon e dytë ma dha Florenc Hoxha

Deputeti demokrat, Ervin Saliianji është paraqitur në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, dje për të dhënë shpjegime lidhur me dy video të dosjes "Babalja". Saliianji u pyet këtë herë si person nën hetim për akuzën e "kallëzimit të rremë". Pas daljes nga prokuroria, deputeti demokrat u shpreh se rrjedha e hetimit ka ndryshuar. "Prokuroria ishte po aq e qartë sa edhe publiku, që rrjedha e hetimit ka ndryshuar dhe kam dhënë edhe persona të tjerë që kanë dijeni për çështjen, apo fakte të tjera që gjenden në fashikullin e prokurorisë, që mund t'i kenë dalë nga vëmendja që Taulanti prej Librazhdit dhe Ard Veliu nga Delvina kanë paguar dhe kanë dhënë 'një pako të mirë' për bëshmitarin kryesor të prokurorisë, i cili në një bisedë të lirë relaksi, duket të plotë, ka treguar të gjithë historinë e vet se si ka ardhur dhe se si është fabrikuar nga Policia e Shtetit dhe nga vartësit e Fatmir Xhafajt, për të shpëtuar jo vetëm vëllain e vet, por edhe lëkurën e vet në krye të Ministrisë së Brendshme", tha Saliianji. I pyetur se cili nga versionet e Fredi Alizotit i besonte, Saliianji pati këtë përgjigje: "Unë besoj në Zot, tek Alizoti beson Edi Rama". Por mësohet se gjatë marrjes në pyetje nga dy prokurorët, Gent Osmani dhe Përparim Kulluri, deputeti demokrat ka dëshmuar se videon e dytë ia ka dhënë ish-kreu i policisë bashkiake, Florenc Hoxha, ndërsa ai nuk ka më shumë material sesa ai i transmetuar.

Qeveria, së shpejti vendim për reagimin e detyruar ligjor nga çdo institucion

Paketa, Rama: Çdo shpifje në gjyq, çdo lek i fituar në Fondin e Edukimit

"Ka ardhur koha të faktojnë para se të akuzojnë"

Darina Tanushi

Çdo ministër dhe çdo deputet i PS-së do të çojë në gjykatë çdo shpifje të bërë nga opozita dhe media. Kryeministri Edi Rama prezantoi dje pika të së ashtuquajturës "Paketa antishpifje", e cila është një propozim për mbledhjen e zgjeruar të grupit parlamentar të PS-së dhe qeverisë. Me paratë që do të marrin nga dëmshpërblimet, drejtuesit socialistë do të shtojnë, sipas kryeministrit, Fondin për Edukimin. "Asnjë ministër dhe asnjë deputet i Partisë Socialiste nuk do të tolerojë më asnjë shpifje. Çdo shpifje të hedhur në drejtimin tonë nga kazani politik e mediatic, a qoftë edhe nga kazani i profileve zyrtare digjitale, ne do ta padisim në gjykatë", u shpreh dje kryeministri Rama. "Boll me përgënjeshtërime, boll me kundërpërgjigje, boll me debate televizive të sajura për t'u bërë jehonë shpifjeve apo për të fituar audiencë e me zhurmen e fabrikës së baltës. Boll me këtë neveri që po helmon Shqipërinë dhe po rrënon çdo gur të themelit të edukatës e mirësjelljes qytetare, të cilin çdo familje e ndërton përditë me aq mund e durim për fëmijët e vet. Çdo shpifje në gjyq! Çdo lek i fituar nga një gjyq për shpifje do të shkojë në Fondin e Edukimit. Ky fond do të krijohet prej nesh për të mbështetur çerdhët, kopshet, bibliotekat e shkollave, nxënësit e mirë të çdo komuniteti, me libra, kompjutera apo materiale mësimore", është ky propozimi i kryeministrit, që do t'i delegohet mbledhjes së grupit parlamentar ditën e hënë. Sipas Ramës, "Fondi i Edukimit do të garantojë që paratë e ardhura nga gjyqet që do të bëjnë kryeministri, ministrat, deputetët, kryebashkiakët socialistë apo të tjerë veprimtarë të forcës sonë politike të gjenden përballë një shpifjeje, të shkojnë në destinacion, mbështetur në propozimin e fituesit të gjyqit. Fondi i Edukimit - propozon kryeministri - do të ketë një bord drejtues, të zgjedhur me propozimin dhe miratimin e mbledhjes së zgjeruar të grupit parlamentar e qeverisë. Ky bord do të trajtojë propozimet e lartpërmendura dhe është e vetmja instancë që mund të vendosë tërheqjen nga një proces gjyqësor për shpifje. Ndërkohë, në Partinë



Kryeministri Edi Rama

Socialiste do të ngrihet menjëherë Departamenti Antishpifje, i cili do të koordinojë dhe ndjekë ecurinë e betejës sonë frontale ligjore kundër Shpifjes. Kazanpolitika dhe kazanmedia s'mund ta kthejnë Shqipërinë në kazan. Shpifësit duhet të paguajnë dhe ne nuk do t'i kalojmë më në heshtje apo me reagime politike, fëlliqësitë e tyre. Çdo shpifje ndaj nesh do ta kthejmë në të ardhura për Fondin e Edukimit. Ngarkohet një grup pune për për-

gatitjen e dokumenteve të themelimit dhe funksionimit të Departamentit Antishpifje dhe Fondit të Edukimit. Këto struktura duhet të jenë operacionale, menjëherë pas kalimit në Kuvend të Paketës Antishpifje", u shpreh dje Rama. Kreu i qeverisë dhe i PS-së pret propozime nga çdo pjesëtar i grupit dhe i kabinetit të tij. "Këshilli i Ministrave do të diskutojë së shpejti projektvendimin për reagimin e detyruar ligjor ndaj shpifjes, të çdo institucioni

TALUANT BALLA
"Lulzim, se sa i vendosur je ti e dinë të gjithë, po ndonjë provë për akuzat ndaj meje ia dhe prokurorisë? Se në fund nuk është një kazan që ndahet e vërteta, po më pas edhe në gjykatë për dëm moral dhe aty do të ta mat kokën mirë, se me lekët që do paguash si shpifës, do rindërtoj një kopsh të ri në Librazhd o pinok", iu drejtua dje, deputeti i PS-së, kreut të opozitës.

Albert Veliu: Kam frikë të kthehem në Shqipëri

Kosovë, Gjykata e Prishtinës liron "Babalen": Ka kërkuar azil politik

Gjykata e Prishtinës liroi dje Albert Velium të ashtuquajtur "Babale". Ndërsa ai pritej të ekstradohej në Tiranë, Gjykata e Prishtinës nuk ka pranuar kërkesën e autoriteteve shqiptare për paraburgim ndaj "Babales", me argumentin se ka kërkuar statusin e azilantit me pretendimin se në Shqipëri i rrezikohet jeta. Albert Veliu akuzohet në Shqipëri për kallëzim të rremë për rastin e audiopërgjimit të pretenduar të Agron Xhafajt dhe kalim të paligjshëm të kufirit. "Babalja" u lirua rreth 24 orë pas ndalimit nga policia e Kosovës. Në një komunikim telefonik me "News 24", Veliu tha se ka frikë të kthehet në Shqipëri. Avokati i "Babales", Tomë Gashi tha se klienti i tij, Albert Veliu ndodhej me të pas vendimit të gjykatës. Në vendimin e



gjykatës thuhet se përfaqësuesi i akuzës, prokurori Hivzi Bajraktari ka kërkuar masën e sigurimit personal arrest me burg për Velium, me qëllim ekstraditim në Shqipëri, në bazë të urdhër-arrestit të lëshuar nga autoritet shqiptare, që e akuzojnë për veprat penale "Kallëzim të rremë në bashkëpunim" dhe "Kalim i paligjshëm i kufirit". Vetë Veliu, sipas dokumentit, ka

kundërshtuar masën e kërkuar nga organi i akuzës, duke thënë se ka kërkuar azil në Kosovë, pasi në Shqipëri i rrezikohet jeta. Argument ky, që u përmend edhe nga avokati, Albert Veliu ka kërkuar azil në Kosovë bashkë me djalin e tij 18-vjeçar, Ledio. Ndërsa bashkëshortja dhe djali i mitur ndodhen si azilantë në Belgjikë. Nga ana tjetër, avokati i "Babales", Tomë Gashi ka përdorur si argument gjatë seancës precedentin e ekstradimit të "gjenistëve" të Erdogan dhe ka thënë se nëse klienti i tij do mbahej, ky do ishte skandal i më i madh juridik pas rastit të turqve. Në përfundim, referuar argumenteve të palës mbrojtëse, Gjykata e Prishtinës ka vendosur të lërë të lirë Albert Velium, i cili kthehet në kampin e azilantëve.

VETINGU NE POLITIKE

DEBATI

PS, Hysi: E turpshme dhe e dënueshme të fyesh përfaqësuesit e organizatave

Vetingu diskutohet me shoqërinë civile, Alibeaj: Teatër. Ruçi: Avash ti

PD: Balla del në çdo episod kriminal

Valentina Madani

Thirrja e shoqërisë civile në seancë dëgjimore në Këshillin e Legjislacionit për vetingun në politikë shkaktoi debat dhe mes PD-së dhe PS-së. Demokrati Alibeaj i kërkoi shoqërisë civile që të mos bëhet pjesë e fasadës së mazhorancës, pasi ajo ka vendosur që të mos e miratojë nismën për ndryshimet kushtetuese. "Ky është një tatar hipokrizie, që po zhvillon Komisioni i Ligjive dhe Këshilli i Legjislacionit me një qëllim të vetëm, për t'i hedhur hi syve të publikut. Përfundimi i kësaj procedure, e cila shndërruar në mënyrë aspak elegante dhe një procedurë përdorimi dhe fasade të qëndrimit që këta zotërinj nuk duan ta shprehin publikisht, mohim total të kësaj kërkesë urgjente, emergjente, uluritëse të publikut shqiptar është thjesht për të blerë kohë, duke bërë një teatër. Me gjithë respektin dhe konsideratën që kam për ju 5 përfaqësues të shoqërisë civile, mos e lejoni veten të përdoren si fasadë, për këtë qëllim të mohimit të vetingut në politikë, të përdoren nga këta. Do të ishte shërbimi më i keq që i bëhet publikut. Ju këni krijuar emrin tuaj, eksperiencën tuaj vetë me kontributin tuaj, pa asnjë lloj ceni, pa asnjë lloj korruptimi me politikën. Nuk jeni thirrur asnjëherë në çështjet më delikate që ky parlament dhe kjo godinë ka diskutuar historikisht, asnjëherë nuk ju kanë thirrur. Ju thërrasin sot për një çështje që e kanë dhënë verdiktin. Nuk e duan. Sot janë duke ulajtur teatrin hipokrit të radhës, gjasma po konsultohen me shoqërinë civile", deklaroi deputeti i PD-së. Alibeaj debatoi me kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçin dhe me pas braktisi mbledhjen e Këshillit të Legjislacionit, teksa hodhi akuza edhe ndaj kreut të grupit të socialistëve. "Taulant Balla del në të gjitha episodet kriminale së paku të muajve të fundit", theksoi z. Alibeaj. Pas largimit të përfaqësuesit të opozitës, edhe disa nga përfaqësuesit e shoqërisë civile nuk pranuan që të bëhen pjesë e debatit politik. Për shumicën, largimi i Alibeajt është shkelje e Kodit të Etikës, për të cilin ata kërkojnë që të merren masa. "Do të ketë një qëndrim lidhur me shkeljen e Kodit të Etikës, por edhe nga ana e shkeljes së rregullores së Kuvendit", theksoi deputeti



Mbledhja e djeshme e Këshillit të Legjislacionit

DEBATI MES ALIBEAJT DHE RUÇIN NË KËSHILL

Gramoz Ruçi: Avash, avash ti! Këtu e drejtoj unë mbledhjen. Nuk të kam thirrur ty, por shoqërinë civile, të lutem nëse ata do të kenë pyetje, je i lirë. Ka mundësi të më dëgjosh mua. Do i lëmë të shprehën vetë ata, apo jo?

Enkelejd Alibeaj: Shoqëria civile të mos lejohet që të përdoret si fasadë.

Gramoz Ruçi: Të lutem, të lutem!

Enkelejd Alibeaj: Ligjin sot e bëjnë bandat në Bllok dhe në Shkodër.

Gramoz Ruçi: Faleminderit! Faleminderit! Kjo mbledhje është vetëm për ju, përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Enkelejd Alibeaj: Ata që nuk erdhën sot (dje) e dinin se është farsë, u ftuan 20 erdhën vetëm 5. (Largohet nga mbledhja).

Gramoz Ruçi: Nuk vend që të dëgjonim ju, dëgjojmë përfaqësuesin e opozitës. Duhet të ishte relatori i opozitës këtu. Tani drejtimin ia lë kolegës për shkak të axhendës.


Ulsi Manja: Do të ketë një qëndrim lidhur me shkeljen e Kodit të Etikës, por edhe nga ana e shkeljes së rregullores së Kuvendit.

i PS-së, ndërsa Vasilika Hysi në një status në "Facebook" deklaroi: "Të ftosh organizata të shoqërisë civile në konsultim publik dhe të fyen, kërcënohen përfaqësuesit e tyre në prani të medias, kjo është e turpshme dhe e dënueshme. Opozita nuk mund të vijë në pushtet me këtë sjellje, por as nuk mund të demtojë pjesëmarrjen publikë në procesin e ligjërjes dhe të konsultimit. Kjo ndodhi sot (dje), në mbledhjen e

përbashkët të Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në rend e dritës të së cilës ishte nisma ligjore e grupit parlamentar të PD-së dhe grupit parlamentar të LSI, 'Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë'. Ndjesë të gjithë juve që u lënduat në mjediset e Kuvendit!", shprehet zj.Hysi.

ENKELEJD ALIBEAJ

"Nuk jeni thirrur asnjëherë në çështjet më delikate që kjo godinë ka diskutuar për çështje me interes për ju. Ju thërrasin sot për një çështje për të cilën e kanë dhënë verdiktin, nuk e duan. E sot po bëjnë teatër, gjasma po konsultohen me juve", theksoi deputeti demokrat.



Presidenti Ilir Meta, gjatë vizitës së djeshme në Tropojë

Aleatët, thirrje PD-së: Jo bojkotit të Reformës Zgjedhore

Aleatët e Partisë Demokratike i kërkojnë Lulzim Bashës që të mos qëndrojë larg tryezës së Komisionit të Reformës Zgjedhore, një proces që sipas tyre nuk duhet të kushtëzohet nga nisma që synon pastrimin e politikës nga krimi. Kryerепublikani Fatmir Mediu deklaroi dje për TV "Klan" se: "Opozita duhet të shkojë dhe të diskutojë për çështje të rëndësishme. Ne kemi qenë dhe duhet të jemi pjesë e këtij procesi dhe të zgjidhim problemet. Si element komplementar është garantimi i qytetarëve në këtë proces. Opozita duhet të shkojë të diskutojë për çështje të rëndësishme". Kurse kreu i agrarëve, Agron Duka u shpreh: "Lufta të jetë paralele shkëputjen nga krimi dhe njëherazi edhe Reforma Zgjedhore. Kryefjala e opozitës është të bëjë çfarë është e mundur që krimi mos futë durart në politikë, por kjo nuk shkon vetëm, por me ndryshimin e sistemit zgjedhor dhe kjo është në favor të qytetarëve". Prezanti ndahen kur bëhet fjalë për ndryshimin e sistemit, që sipas tyre ka prodhuar pasojë shumë të dëmshme jo vetëm në funksionimin e shtetit,



APELI

Ky qëndrim i aleatëve të Lulzim Bashës vjen në një kohë kur opozita ndodhet jashtë Komisionit të Reformës Zgjedhore dhe kur PD ka prezantuar platformën e saj për çlirimin e zgjedhjeve nga krimi ku dekriminalizimi dhe vetingu i politikës shikohen si emergjencë kombëtare për një proces të lirë e demokratik.

por edhe kushtetuese. "Po nuk u reformua sistemi zgjedhor, demokracia është në rrezik të madh", theksoi kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi. Sipas Mediu: "Ky është më parlamentar përfaqësues i qytetarëve, por i interesave të kryetarëve dhe ka krijuar një elitë false, që s'ka lidhje me votuesit". Ndaj edhe ndryshimin e sistemit e shohin jetik për demokracinë, ndonëse nuk hezitojnë të pranojnë se dy partitë e mëdha po tentojnë të shkojnë në zgjedhje me kodin e vjetër. "Besoj se po, edhe pse Bashka ka thënë pasi të zgjidhim problemet. Jam për një sistem që u jep të drejtën qytetarëve

të zgjedhin kush i përfaqëson", u shpreh z.Mediu. Për Dashamir Shehin: "Elementë maxhoritarë brenda ligjit të ri e dyta një korrektim kombëtar, listë proporcionale kombëtare që do t'i bashkonte shqiptarët". Ky qëndrim i aleatëve të Lulzim Bashës vjen në një kohë kur opozita ndodhet jashtë Komisionit të Reformës Zgjedhore dhe kur Partia Demokratike ka prezantuar platformën e saj për çlirimin e zgjedhjeve nga krimi ku dekriminalizimi dhe vetingu i politikës shikohen si emergjencë kombëtare për një proces të lirë e demokratik.



Xhaçka: Kjo bazë është gjurma e parë e NATO-s në Ballkanin Perëndimor

"Reuters": Varreza shqiptare e 'Mig'-ëve shndërrohet në bazën ajrore të NATO-s

"Do të shpenzohen mbi 50 milionë euro në fazën e parë"

Për një kohë të gjatë ka qenë varreza e forcave ajrore, baza shqiptare në Kuçovë do të bëhet një qendër e NATO-s, që do të sjellë kënaqësi për aviatorët, të cilët presin të dëgjojnë sërish zhurmën e motorëve të 'ulërijnë', shkruan agjencia zyrtare britanike e lajmeve, "Reuters", në një artikull që ia dedikon bazës së parë ajrore të NATO-s në Ballkan, e cila do të ngrihet në Kuçovë. Shqipëria i uli përfundimisht 224 'Mig'-ët e saj sovjetike dhe kinezë në vitin 2005 dhe që prej vitit 2009, fqinjët e NATO-s, Greqia dhe Italia monitorojnë hapësirën e saj ajrore. Kjo solli një rënie të ekonomisë përreth Kuçovës, që dikur quhej "Qyteti i Stalinit" gjatë epokës komuniste. "Kjo bazë është gjurma e parë e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, pasi do të transformojë Kuçovën në bazën e parë ajrore të NATO-s për këtë rajon", thotë ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka për "Reuters". "NATO-ja do të shpenzojë mbi 50 milionë euro në fazën e parë të punës për ta kthyer Kuçovën në një bazë mbështetëse për furnizime, logjistikë, trajnim dhe manovra", tha Xhaçka. Shqipëria mendon se e ka futur një transformim të tillë në këtë bazë për ndihmën që ka dhënë në ruajtjen e stabilitetit në Ballkan dhe kontribut në misionet paqeruajtëse të NATO-s përreth botës. "Rajoni, si i tërë ka hyrë në një proces të integritetit Euro-Atlantik", shtoi Xhaçka. Lajmet për një bazë të NATO-s kanë rritur shpresat në Kuçovë. Civilët e shohin projektin e bazës si një nxitje ekonomike për një zonë të rritur nga emigrimi dhe papunësia. Gjenerata e fundit e pilotëve të trajnuar, tani në të pesëdhjetat, janë të etur të dëgjojnë zhurmën e motorëve përsëri, ndërsa më të rinj në këtë zonë largohen nga puna për shkak të rrogave të tyre të ulëta. Delet kullosin në shkurret mes korsivë të uljes dhe pistës. Rreth 88 'Mig' qëndrojnë me gomat e shfryra pranë tre hangarëve nëntokësorë, ndërsa zogjtë këndojnë sipër tyre. Pista, e konceptuar nga inxhinierët sovjetikë, e cila ruante dinamit nën të për ta hedhur në erë nëse do të duhej për të mos rënë



Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka

SHKURTE

Presidenti shkon në Tropojë, pritet me këngë e valle

Presidenti i Republikës, Ilir Meta nisi një vizitë në rrethin e Tropojës, duke bërë ndalesën e parë në fshatin Plerzë, ku mori pjesë në ceremoninë e inaugurimit të rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare "Matosh Uka", ku ishin të pranishëm kryetari i Bashkisë së Tropojës, Besnik Dushaj; ambasadori i Japonisë në Shqipëri, Makoto Ito dhe përfaqësues të pushtetit vendor. Ky investim i realizua falë fondeve të Qeverisë japoneze dhe kompanisë së sigurimeve 'SIGAL'. Presidenti Meta, pasi u takua me nxënësit dhe mësuesit, të cilët e pritën me këngë e valle popullore të zonës, u shpreh: "Ndihem shumë i lumtur të marr pjesë në ceremoninë e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare 'Matosh Uka' në Plerzë të Tropojës, që falë bujarisë së qeverisë japoneze dhe kompanisë së sigurimeve 'SIGAL', ka sot kushte plotësisht moderne. Me urimin për një vit të mbarë shkollor, jam besimplotë se këta nxënës të mrekullueshëm, duke ndjekur ëndrrat e tyre, do të jenë nesër elita intelektuale e vendit, ashtu si shumë prej të parëve të tyre, që ndër vite i kanë dhënë krenari Tropojës dhe Shqipërisë", - u shpreh Presidenti Meta.

Presidenti Meta hap garën për kreun e ri të KLSH-së, Leskaj i mbaroi mandati

Presidenti Ilir Meta hapi dhe zyrtarisht garën për pasuesin e kreut të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bujar Leskaj, mandati i të cilit përfundon më 22 dhjetor 2018. Në garë, Presidenti Meta fton të gjithë të interesuarit, të cilët plotësojnë kriteret e ligjit. "Afati i paraqitjes së shprehjes së interesit, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm do të jetë duke filluar nga data 12 tetor 2018 deri më datë 30 tetor 2018", thuhet në njoftimin e Presidencës. Mandati i kreut të Kontrollit të Lartë të Shtetit është 7-vjeçar. Procedura e parashikon që garën e hap Presidencia, ndërsa kryesuesin e KLSH-së e zgjedh Kuvendi me votë. Kompromisi politik deri më tani ka qenë që emri i kreut të KLSH-së t'i lihej opozitës. Mbetet për t'u parë nëse edhe për pasuesin e Bujar Leskaj do të ndiqet e njëjtë praktikë. "Kandidatit të përzgjedhur për këtë pozicion kush-tetues do t'i kërkohet paraqitja e dokumentacionit shtesë si më poshtë: formulari i vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike'; Formulari i aplikimit të plotësuar 'Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta', në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 'Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë' si dhe vetëdeklarim i aplikantit se nuk ndodhet në kushtet e pengesës ligjore të papajtueshmërisë së funksionit sipas përcaktimeve të nenit 21 pika 1, të ligjit nr.154/2014 'Për organizimin dhe funksionimin e KLSH'".

Kreu i Kuvendit pret ambasadorin e ri, Soreca: Po punojmë për Shqipërinë në BE

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi priti dje ambasadorin e ri të misionit të BE-së në Tiranë, z. Luigi Soreca. Pasi e uroi ambasadorin Soreca për misionin e tij në Shqipëri, kryetari i Kuvendit informoi gjerësisht mbi veprimtarinë dhe kontributin e Kuvendit në tri aspektet kryesore: kurorëzimin me sukses të hapjes së negociatave në qershor 2019, vazhdimin me vendosmëri të reformës në drejtësi dhe procesit të vetingut, përfundimin e reformës zgjedhore. "Kuvendi është i angazhuar për realizimin e të gjitha detyrimeve të tij për kurorëzimin me sukses të hapjes së negociatave në qershor 2019. Pas publikimit të raportit me rekomandimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë, në maj 2018, Kuvendi hartoi Planin e Veprimit me 6 objektiva dhe 46 masa për realizimin e tyre. Deri më 1 tetor janë realizuar 22 nga 37 masa të parashikuara për periudhën 1 maj-31 tetor 2018, ndërsa 15 masa janë në proces. 9 masat e tjera janë programuar të realizohen gjatë periudhës 1 nëntor 2018-prill 2019", tha Ruçi në paraqitjen e tij. Në lidhje me ecurinë e reformës zgjedhore, kryetari i Kuvendit nënvizoi se Komisioni i Reformës ka bërë një punë të shkëlqyer, por është i nevojshëm vullneti politik i partive, të cilat duhet të afrohen në qëndrimet e tyre, në emër të interesave të vendit. "Nëse partitë arrijnë një kompromis, reforma miratohet që nesër", nënvizoi kryetari i Kuvendit. Ambasadori Soreca nënvizoi se të të muajt e ardhshëm janë vendimtarë për Shqipërinë. "Objektivi i BE-së është i qartë: Shqipëria duhet të jetë në BE dhe për këtë po punojmë të gjithë", u shpreh ambasadori Soreca. Por për këtë duhen rezultate konkrete, sidomos në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Reforma në drejtësi po lavdërohet për kurajën dhe përgjegjësinë që po demonstrohet për zbatimin e saj. Vetingu po funksionon, por është shumë e rëndësishme të krijohet organet e reja të sistemit dhe për këtë duhet shtuar përpjekjet. Përsa i përket reformës zgjedhore, ajo po shkon drejt përfundimit, por për këtë duhet që partitë të mbështesin me shumë Komisionin e Reformës dhe të arrijnë një kompromis në të mirë të vendit.



Qeveritë Kosovë-Shqipëri, mblidhet për të pestën herë, takimi në Pejë

Qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës do të mblidhen së bashku në Pejë, në muajin nëntor për të pestën herë së bashku. Në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme u zhvillua takimi përparimor për mbledhjen e përbashkët të qeverive Shqipëri-Kosovë. Gjatë këtij takimi u vlerësua ecuria e deri tanishme e vendimeve të marra dhe u analizuan elementet që do të duhet të trajtohen gjatë mbledhjes së ardhshme të përbashkët të dy qeverive. Mbledhja e radhës do të mbahet në muajin nëntor në Pejë dhe do të ketë në fokus nënshkrimin e marrëveshjeve kryesive me karakter ekonomik dhe që lehtësojnë jetën e qytetarëve të të dyja vendeve. Kjo është mbledhja e 5-të që zhvillohet mes dy qeverive. Mbledhja e fundit u zhvillua në qytetin e Korçës më 27 nëntor të vitit të shkuar në të cilën u nënshkruan dymbëdhjetë marrëveshje dhe memorandumet kryesive të integrimit Euro-Atlantik, diplomacia, ekonomia, tregtia, diaspora, kultura, infrastruktura.

në duart e armikut dhe që ishte ndërtuar nga të burgosurit politikë në vitet 1950, ka kushte të mira motti gjatë gjithë vitit. "Një bazë e NATO-s do të rrisë kapacitetet mbrojtëse të vendit dhe investitorët e huaj do të kenë më shumë besim në Shqipëri. Do të jetë gjithashtu, diçka e mirë për punësimin në rajon", tha komandanti i Forcave Ajrore, 68-vjeçari në pension, Klement Aliakaj.

KPK anashkaloi prova të shumta, që e lidhin gjyqtarin e Gjykatës Administrative të Apelit me një vilë në qytetin bregdetar

Si e "fshehu" gjyqtari Artur Malaj vilën 3-katëshe në Vlorë nga vetingu

"Familjarët e tij dhe personat e lidhur zotërojnë mijëra metra katrorë tokë"

Aleksandra Bogdani,
Besar Likmeta

Ervin Çeta, ish-kampi kombëtar boksi me klubin sportiv "Flamurtari" u rrit përballë një fushe sportive pas shkollës së mesme "Halim Xhelu" në qytetin e Vlorës, në oborrin e së cilës luante futboll dhe ushtronte muskujt mbi paralele. Në një cep të oborrit të shkollës, aty ku dikur ndodhej një vendstrehim i nëndheshëm antiajror, që banorët e zonës i referohen si "tuneli", ngrihet sot një vilë e madhe trekatëshe me papafingo, grila persiane, kangjella hekuri dhe porta automatike. "Kam nostalgji, pasi në oborrin e shkollës luanim futboll. Këtu ku ndodhet shtëpia, më parë ishte vendstrehimi", kujton Çeta, i cili e ndan jetën mes Vlorës dhe qytetit të Otrantos në Itali, ku punon si bahçevan. "Shtëpia është e boshatisur prej vitesh dhe e vizitohet rrallë gjatë beharit, pasi janë zhvendosur të gjithë në Tiranë", tregon ish-boksieri, i cili ka zhvilluar 11 ndeshje ndërkombëtare. Sipas banorëve të lagjes "Kushtrimi", pas mureve të dekoruara me tulla terakotë jetonte dikur Artur Malaj, për shumë vite kryetar i Gjykatës së Vlorës dhe prej vitit 2013, gjyqtar në Gjykatën e Administrative të Apelit në Tiranë. Përveç dëshmi të fqinjëve, fije të shumta verbale dhe shkresore, një raport i deklasifikuar i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, një denoncim në KLD, si dhe dokumente të ILDKPKI-së dhe institucioneve të tjera e lidhin ngushtësisht gjyqtarin Malaj me këtë vilë, e cila ka një origjinë prone të dyshimtë dhe është regjistruar në hipotekë në emër të ish-sekretares së tij. Megjithatë, sinjalet e shumfishta se vila mund të jetë pasuri e fshehur e gjyqtarit u anashkaluan nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili më 3 gusht mori vendimin për ta konfirmuar në detyrë Malajin me argumentin se ai "ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale". Vila pas shkollës "Halim Xhelu" nuk është e vetmja pronë që ka ngritur dyshime mbi integritetin e gjyqtarit Artur Malaj. Sipas provave të administruara nga KPK, famil-



Gjyqtari Artur Malaj

DESHMIA

Ish-agronomi në pension: Vila i është shitur kryegjyqtarit

Një ish-agronom në pension që kultivon lule dhe pemë dekorative në oborrin e marrë me qira të një shtëpie të vjetër përkrah vilës 3-katëshe e lidhi ndërtesën me gjyqtarin Artur Malaj. Por, ndryshe nga 87-vjeçarja, agronomi e kishte njohur Sokrat Dautajn. "Unë di që Sokrat Dautaj ia ka shitur vilën kryegjyqtarit të Vlorës shumë herët. Unë e njihja Sokratin se më pati lidhur një çështje e imja dhe u habita", tha ai me lëndatë për avokatin e ndjerë. Agronomi në pension, i cili e nisi biznesin e tij të



vogël të luleve në '97-ën "kur të tjerët merrshin me armë", përshkruan të njëjtin historik të pronës. Lidhur me gjyqtarin Malaj dhe familjarët e tij, ai tha se kanë jetuar për shumë vite aty, por ai nuk kishte njohje personale se "ishin të ardhur". Ish-

agronomi për korrupsion, gjyqtari Malaj i mohoi akuzat dhe i cilësoi raportimet e DSJK-së si të pasakta. Ai shtoi gjithashtu se nuk kishte qenë në dijeni të transakcioneve të kunatit me pronat, të cilat tha se janë bërë me kontrata të rregullta dhe transferta bankare. "Aty ka jetuar vëllai im, Afrimi dhe nëna ime. Njerëzit mund ta kenë ngatëruar vëllain me mua", tha Malaj, duke shtuar se nuk e dinte kush nga fqinjët ka folur, por vetë ai i kishte çuar deklaratat e tyre në KPK. "Akuzat për korrupsion janë të pasakta. Një nga raportimet i përket një përdhunuesi që është liruar nga Apeli, tjetra është për një short në kohën kur unë

kam qenë gjyqtar në Tepelenë dhe jo në Vlorë dhe e treta i referohet shtëpisë 3-katëshe, ku thuhet që është ndërtuar nga babai im në kohën që ai kishte vdekur", tha Malaj.

VILA 3-KATËSHE MBI BUNKER

Artur Malaj ka një karrierë të gjatë në sistemin e drejtësisë dhe prej korrikut 2013 është gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit. Ai ka drejtuar Gjykatën e Vlorës nga viti 2004 deri në vitin 2013, kur u promovua nga Presidenti i Republikës si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit. Malaj ka qenë gjithashtu edhe anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Ai u nënshtrua procesit të vetingut me përparësi,

boksieri Ervin Çeta, i cili në Vlorë e mban gjallë pasionin për sportin përmes stërvitjes së djemve të vegjël, kujton se familja Malaj erdhi aty në të njëjtën kohë me familjen Simoni (rreth krushqie), e cila banon vetëm disa metra më tutje. Përballë vilës 3-katëshe ndodhet edhe një tjetër e ngjashme, e zotëruar nga të afërmit e tyre, të familjes Gërveni. "Shtëpia është ndërtuar nga i vëllai, por nuk ka qenë kështu siç e shihni ju sot. Vila është bërë më vonë", thotë Çeta. "Jetoni në gjithë këtë, gjyqtari, vëllai, mamaja", shtoi ai.

me qenë gjyqtar në Tepelenë dhe jo në Vlorë dhe e treta i referohet shtëpisë 3-katëshe, ku thuhet që është ndërtuar nga babai im në kohën që ai kishte vdekur", tha Malaj.

VILA 3-KATËSHE MBI BUNKER

Artur Malaj ka një karrierë të gjatë në sistemin e drejtësisë dhe prej korrikut 2013 është gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit. Ai ka drejtuar Gjykatën e Vlorës nga viti 2004 deri në vitin 2013, kur u promovua nga Presidenti i Republikës si gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit. Malaj ka qenë gjithashtu edhe anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Ai u nënshtrua procesit të vetingut me përparësi,

C'THOTE GJYQTARI

Në deklaratat e tij për komisionin, gjyqtari Malaj pretendon se nuk ka pasur dijeni mbi lidhjet dhe pronat e familjarëve të tij dhe nuk ka pasur përfitime nga këto pasuri, arsyetim i cili është pranuar nga trupa gjyqkuese e udhëhequr nga Genta Tafa Bungo, e cila ka votuar unanimitisht për konfirmimin e tij në detyrë.

për shkak të kandidimit të tij për postin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, institucionit të ardhshëm që do të zëvendësojë Inspektoratin aktual të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe që do të ketë për detyrë të hetojë shkeljet e mundshme të gjyqtarëve në të ardhmen. Analiza e deklaratave të pasurisë të dorëzuara në ILDKPKI tregon se pasuria familjare e tij është rritur me 47 herë nga viti 2003 dhe ka si burim kryesor aktivitetin e bashkëshortes si notere. Vila e ndërtuar prej një dekadë pas shkollës "Halim Xhelu" në Vlorë dyshohet se është pjesë e padekluarur e kësaj pasurie.

Banorët e lagjes "Kushtrimi" i thanë BIRN se familja e gjyqtarit Malaj është vendosur në rrugicën pas shkollës "Halim Xhelu" në fillim të viteve '90 nga fshati Llakatund, pasi ndërtuan më parë një shtëpi pa leje, në gjurmët e së cilës u ngrit më pas vila 3-katëshe. Të dhënat e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive në Vlorë dhe të Gjykatës së Vlorës tregojnë se trulli prej 478 m² dhe ndërtesa e vjetër prej 90 m² u regjistruan fillimisht në emër të shtetasit tashmë të ndjerë Sokrat Dautaj, ish-avokat dhe ish-gjyqtar në Gjykatën e Vlorës. Dautaj e përfitoi pronën publike nëpërmjet një gjyqi kundër Bashkisë së Vlorës në vitin 2005, duke paraqitur 2 dëshmitarë, të cilët pretenduan se babai i tij e kishte ndërtuar shtëpinë në vitin 1984. Gjyqi është mbajtur në mungesë të përfaqësuesve të Bashkisë së Vlorës dhe Avokaturës së Shtetit. Sipas vendimit të Gjykatës së Vlorës, avokati Dautaj e ka fituar pronësinë e objektit dhe të trullit nëpërmjet institutit të parashkrimit fitues. Sokrat

Dautaj ndërroi jetë në vitin 2007 dhe prona u trashëguara nga e veja Beatrice dhe dy vajzat Alma dhe Blerina Dautaj. Në emër të Beatrices dhe 2 vajzave të saj në vitin 2009 nga Bashkia Vlorë është marrë një leje ndërtimi për rikonstruksionin dhe ndërtimin e vilës 3-katëshe me sipërfaqe ndërtimi 204.5 m². Vila në emër të familjes Dautaj është deklaruar si adresë nga gjyqtari Artur Malaj në deklaratat periodike të dorëzuara në ILDKPKI. Adresa "Lagja Kushtrimi", Rruga "Dëshmorët" është deklaruar gjithashtu si adresë banimi prej tij në dosjen e një kredie të marrë në "Raiffeisen Bank" në vitin 2005. Të njëjtin adresë kanë në regjistrin civil nëna e gjyqtarit, Xhano Malaj dhe vëllai i tij, Afrim Malaj, i cili jeton tashmë në Itali. Kontrata e sipërmarrjes për ndërtimin e vilës me shpërndarje dhe ndërtimit "Desi sh.p.k" është redaktuar në vitin 2009 nga noterja Ledina Malaj, bashkëshortja e gjyqtarit. Kjo adresë familjare deklarohet nga Ledina Malaj edhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në vendimin e regjistrimit të biznesit të noterisë në vitin 2005. Gjyqtari Artur Malaj pranoi në një bisedë telefonike me BIRN se e kishte deklaruar si adresë vilën në lagjen "Kushtrimi" për shkak të pamundësisë, pa sqaruar se ku kishte jetuar në atë kohë. "Unë e kam deklaruar në KPK se ku kam jetuar. Unë dhe bashkëshortja ime e kemi deklaruar atë si adresë, pasi nuk kishim adresë", i tha Malaj BIRN. Por, prezenca e Malajit në këtë banesë konfirmohet nga fqinjët e rrugicës "Dëshmorët", që banojnë ngjitur me vilën 3-katëshe dhe oborrin e rikonstruksionit të shkollës "Halim Xhelu". Një zonjë e moshaar dhe fqinje "derë më derë" me vilën kujtoi kohën kur fadromat shembën "tunelin e ushtrisë për të ndërtuar pallatin". Banore e zonës prej vitit 1982 dhe rrobapepese për disa dekada gjatë regjimit komunist, e moshuara 87-vjeçare, e cila njihet prej fqinjëve si nënë Mellania i tha BIRN me hezitim se kishte pasur hyrje-dalje për raste me nënën e Malajit. Ajo kujtoi se e gjithë familja, me përjashtim të babait, që sipas saj kishte vdekur në fshat, u vendosën aty në fillim të viteve '90. "Kanë më shumë se 3 vjet që kanë ikur në Tiranë dhe nuk i kam parë më. Ku ata, e ku ne tani", tha e moshuara, duke iu referuar diferencës "klaseore".

E moshuara e përkshkroi Malajin si djale shumë të mirë, por si gjyqtar, ajo vetë s'kishte pasur ndonjëherë nevojë për gjyqe. E pyetur për Sokrat Dautajn, ajo tha se nuk e njohnte dhe nuk e kishte parë ndonjëherë. "Unë e kujtoj pse jeni ju këtu, por nuk di më shumë. Ndoshta ai (Sokrat) e ka", tha 87-vjeçarja me flokë të bardhë të shndritshëm. "Por, ne na kanë mësuar që kush gënjen, kush vjedh, kush mashtron ka për të dalë një ditë", shtoi ajo.

Ish-truproja e Sali Berishës shkruan nga 'burgu 302' në Tiranë: Ja kush po na sulmon mua dhe Erjona Parrucën

Izet Haxhia: Do të hap 'kutinë e Pandorës'


"Nuk ka dalë akoma një trupë gjyquese, edhe pse afatet ligjore janë tejkaluar"

Izet Haxhia, truproja e parë e ish-kryemnistrit Berisha, në një letër të dërguar në redaksinë e televizionit "News 24", bën të ditur faktin se avokati e ka braktisur prej 2 muajsh, asnjë prokuror nuk ka shkruar ta marrë në pyetje, ndërsa për herë të parë akuzon vëllain e tij, Ismet Haxhin dhe Romeo Karajn se po sabotojnë çështjen e tij në gjykatë. "Jam i detyruar t'ju drejtohem me anë të kësaj letre, për arsye se nuk kam asnjë mundësi tjetër komunikimi, pasi nuk më është dhënë e drejta të flas me asnjë media. Në bazë të rregullores së parburgimit, për të folur me mediat kërkohet leja nga prokurori i çështjes. Por nuk ka akoma asnjë prokuror dhe asnjë trupë gjyquese për çështjen që do rigjykohej", shkruan Haxhia. Ai flet për një sulm të organizuar ndaj tij dhe të dashurës Erjona Parruca, sulm që ka si qëllim dëmtimin e çështjes në gjykatë e që për organizatorë ka dy persona.

LETRA E PLOTË PËR "NEWS 24"

Përsëhëndetje!

Jam i detyruar t'ju drejtohem me anë të kësaj letre, për arsye se nuk kam asnjë mundësi tjetër komunikimi, sepse nuk më është dhënë e drejta të flas me asnjë media. Në bazë të rregullores së parburgimit, kërkohet leja nga prokurori i çështjes për të folur me mediat. Por nuk ka akoma asnjë prokuror dhe as edhe një trupë gjyquese për çështjen që do rigjykohej. Në mungesë totale të komunikimit dhe të një izolimi të plotë, e ndjej të domosdoshme t'i përgjigjem një sulmi të mirorganizuar e djallëzor ndaj meje dhe Erjona Parrucës. Erjona është shumë më tepër se e dashura ime. Ajo është shoja, mikja, mbështetësa ime besnike. Erjona është nderi im, gruaja ime e jetës. Dua të theksoj se ky sulm mafioz ka si qëllim të dëmtojë çështjen time në gjykatë, të cilës siç citova më lart, nuk i ka dalë akoma një trupë gjyquese, edhe pse afatet ligjore janë tejkaluar. Në krye të këtij sulmi fatkeqësisht ndodhen dy persona, njëri që hijej si "mik" (Romeo Karaj) dhe vëllai (Ismet Haxhia). Këta të dy mashtroren e hajdutë ordinerë që për atdhe, fe e moral kanë lëkurë dhe vetëm lekun, pasi iu sulën Erjonës me statushe dhe sharje ordinere, me mesazhe monstruoze që përmbanin shpifje, sharje perverse, trillime qesharake e deri kërcënime për jetën e saj dhe fëmijëve të saj të mitur. Nuk i mjaftuan me kaq, por duke vendur në përdorim një tufë anonimësh e dallkalkësh në media sociale, arritën deri aty sa e organizohën në këto media, si një bandë, duke u dërguar në seri mesazhe kërcënuese të gjithë atyre që përkrahnin Erjonën në përballjen e saj, ashtu e vetme me këta demonë. Një përballje e Erjonës me kulturë, gjetitari dhe guxim. E vazhduan edhe më tej këtë luftë të tyre të ndyrë duke u dërguar mesazhe të gjithë miqve të mi, ku deklarimin me djallëzinë më të poshtër sikur unë kisha bërë kompromis me Berishën, kisha hequr dorë nga të gjitha denoncimet e mëparshme të miat, të bëra në adresë të Berishës apo siç deklaronte Romi "trimi" që 'qeni u kthye tek i zoti'. Si duket, ky ngatërron rolin e tij të përjetshëm, dikur si zagari i Neritanit, pastaj si zagari i Kastriot Islamit, të cilin edhe pse e mbajti Romin në bukë, e kafshoi si ato zagare që nuk lehin, por kafshojnë në pabesi. Tani është duke bërë rolin e zagarit të Taulantit, të cilin e këshilloj që të bëjë kujdes me këtë zagari të përjetshëm, se po të rrëshqiti këmba, i pari do të kafshohet ty, ky zagari profesionist. Këto shpifje dhe taktika djallëzore të diriguara nga Romi "trimi" më flet edhe Ismet "flokëlyeri". Me këtë pabesi të tyre arritën deri në tradhitinë e paimagjinueshme e pabesi të denja për besthyerit Ber-



Faksimile e letres së Izet Haxhise për "News 24"

KUSH ESHTË ERJONA PARRUCA
 "Në mungesë totale të komunikimit dhe të një izolimi të plotë, e ndjej të domosdoshme t'i përgjigjem një sulmi të mirorganizuar e djallëzor ndaj meje dhe Erjona Parrucës. Erjona është shumë më tepër se e dashura ime. Ajo është shoja, mikja, mbështetësa ime besnike. Erjona është nderi im, gruaja ime e jetës", shkruan Haxhia.

isha. Arritën deri aty sa vëllai im biologjik, Ismeti, tani i kthyer në një vëlla të Romit, i'japë këtë të dhëna nga kronologjia e vrasjes së Azem Hajdarit, që unë në mënyrë konfidenciale i kisha shkruar avokatit tim e që duhet të paraqiteshin në gjyq. Unë u dal për zot të gjitha atyre gjërave që i kam shkruar në mënyrë konfidenciale avokatit tim, por kam edhe plot surpriza të tjera për këtë çështje. Surpriza të pakëndshme si për organizatorët e vrasjes së Azemit, për ata që e nxorën në pritë, për motivin e kësaj vrasjeje dhe për ata që për përzierjen mua, pa dashjen time në këtë vrasje. Boll kam heshtur e mbrojtur të tjerët. Le të hapet "kutia e Pandorës" dhe gjithsecili të marrë atë që i takon. Këto shpifje e skenarë djallëzorë të Romit e Ismetit, më kujtuan një skenar djallëzor të Berishës, të kurdisur ndaj meje në maj të vitit 1999. Nodheshja në Tropojë në atë kohë, kur në 6 maj 1999 u bë prita e parë ndaj Haxhijave me mina të telekomanduar. Kjo pritë ishte organizuar nga njerëzit e Berishës. Por fill pas lajmimit për këtë pritë, Berisha dërgon një të afërmin e vet të takojë në Tiranë Halil Haxhajn dhe ky i afërm i Berishës, i thotë Halilit se kam të dhëna të sigurta që priten e ka bërë Izet Haxhia, por me porosi të Berishës dhe sikur unë kisha marrë 1 milion marka nga Berisha për të vrarë Haxhajn. Por, ana e dhimbshme e këtij sulmi djallëzor që po na bëhet mua dhe Erjonës është se këto akuzat për bashkëpunim me Berishën i organizuan vëllai im batakçi, hajdut e mashtrore si bashku me Romeo "trimin", që mbushi poturet vetëm me një telefon që iu bë nga burgu dhe iku i lebetitur, duke u futur në poturet e qeverisë. Por ky "trim", që trimëria e vetme në jetën e tij është dhunimi i motrës së vet, nuk e ka për gjë të kërcënojë e dhunojë një femër të pambrojtur dhe mua bile... edhe ky një akt i paparë i "trimërisë" i duartkruar nga vëllai im "burrë zakoni". Por e keqja ime e madhe është se, këta të dy batakçin po zbatojnë një skenar të djallit Berisha dhe të paguar prej njerëzve të tij, për të më sulmuar mua. Në jetën time as nuk jam shitur, as nuk shitem kurrë për asnjë çmim. Këta të dy tradhtarë të pabesë e batakçinj, më ngatërronë me veten e tyre, që për para, karierrë e famë shiten edhe tek djalli Berisha. Po si nisi ky sulm që ka brenda vetes, shpifje ordinere, akuzat monstruoze, kërcënime e dhunë psikologjike ndaj një femre të vetme, të pambrojtur e të sëmurdur. Sulme e mashtroje që do ua kishte zili "Babale" e "gjetitari Dixhial". Pasi mora të dhëna të sakta se detysha e batakçinjve Romeo-Ismet po kërkohet para tek njerëz të ndershëm duke përdorur emrin

tim, i kërkova Erjonës që të publikonte në "FB" tim një status ku thuhet që askush të mos përdorë emrin tim për të mbledhur para apo për të bërë reklamë. Dhe fill pas këtij publikimi, Erjona u gjend nën një sulm të paparë e monstruoze. Erjona sipas këtyre sulmeve djallëzore të gatuar në bashkëpunim në kuzhinat e Berishës, nga këta burracakë dhe banda e tyre fejsbukjane, u ngrys brenda një dite një agjente e regjuri. Apo më saktë, në poliagjente, që nga agjente e Berishës e deri tek agjente e DSG-së franceze apo UDB-së serbe. Biles sipas këtyre, ajo ishte një shoqe e ngushtë e Argita Berishës dhe kishin punuar bashkë në Kosovë. Vetëm mendja diabolike e Berishës dhe e këtyre dy burracakëve mund të sajonte shpifje të tilla, sa djallëzore, aq edhe qesharake. Madje, këta "anti-berishianë" të rëbuar arritën deri aty në marrëzinë e shpifjeve të tyre, sa deklaruan që: Erjona kishte marrë si detyrë të saj agjenturore që të më bindte mua të hiqja dorë nga përballja me Berishën në gjykatë dhe të gjitha denoncimet që kisha bërë më parë për krimet e tij, heqjen dorë nga unë për të gjitha të vërtetat që kam deklaruar për krimet e Berishës. Pastaj m'u sulmën mua për të më mbushur mendjen se Erjona donte të më helmonte. Nuk prisja nga këta burracakë shpirtkashëm të më kuptojnë apo mbështesnin në dazhurinë time. Këta njohin vetëm guhën e urrejtjes, millefin, vrerim, komplekset dhe frustrimin e tyre. Sulmi i tyre kalonte çdo kod etik, moral kanunor apo shpellor. Dua të sqaroj njëherë e mirë për publikun se asgjë nuk mund të bëjë dhe të rrugën time për t'u ballafaquar me nxjerrësin në pritë të Azem Hajdarit, Sali Berishën. Asgjë dhe askush nuk do më ndalë të denoncoj krimet monstruoze të Berishës si një dëshmitar i dorës së parë, si një pjesëmarrës dhe zbatues i tyre. Dhe kjo do të bëhet vetëm me të vërtetat e mia të pakundërshtueshme. Ky është një qëndrim i palëkundur i imi, por unë nuk mund të bëj edhe detyrën e prokurorit, të cilët i kam kërkuar dy herë, të vijnë e të më marrin në pyetje. U takon prokurorëve të republikës të vijnë e të më marrin në pyetje, si edhe dëshmitë e mia për të gjitha ato denoncime që kam bërë për krimet e Berishës dhe krimet e tjera të pazbardhura. Jam në pritje të një prokurori të guximshëm, të ndershëm e të pavarur nga politika, të marrë këtë detyrë që i jep Kushtetuta dhe ligjet e shtetit shqiptar. Deri para pesë muajsh nodheshja në Turqi me adresë e vendndodhje të deklaruar, por askush nuk e mori mundimin nga prokuroria të vinte e të më pyeste, goftë edhe për të hedhur poshtë të gjitha ato denonci-

me të miat të bëra publike. Ka qenë rrugë e gjatë e lodheshin, por tani që adresa ime është tek burgu 302, Tiranë, përse nuk vijnë? Nuhas erëra të pista në këtë heshtje varri, që mund të vijnë nga garancitë që i janë dhënë kriminelit Berisha për të mos u përballur me drejtësinë për krimet e tij. Asnjëherë nuk mund të vendoset drejtësi në vendin tonë pa u dënua krimet 97-vjeçare, ku shumica prej tyre kanë dorën dhe vullën e Berishës. Krimet që fillojnë që nga vrasja shtetërore e Remzi Hoxhës, vazhdojnë me ato të '97-s, vrasjen e Hajdarit, grushtin e shtetit shtator '98, vrasjet e Tropojës etj. Jam vetëdijues me vullnetin tim të plotë, edhe pse këta detysha e shpifjeve mundohen ta mohojnë pa asnjë marrëveshje apo pazari me askënd.

Po mirë ore mashtrores i pacipë, desha të të pyes: "Si ka mundësi që një i kërkuar nga Interpoli në të gjithë botën, siç isha unë, të arrihet në një vend si Turqia, në gjendje të jashtëzakonshme që të heqin edhe lidhëset e këpuçeve e deri unazën në gisht, t'i lejohej telefoni celular, të komunikojë me të. Të mos i vihen prangat, të mbahet në zyrat e shefit të policisë? Vetëm mendja jote e përcudnuar mund të sajtojë një gjenjeshtrë të tillë, apo gjenjeshtrë tjetër që unë me zë të dridhur të paskam marrë ty në telefon, e të paskam kërkuar të njoftosh mediat. Por, lajmim prej vetëdijezimit tim mor batakçi, të gjitha mediat e morën vesh nga statusi im në "Facebook" dhe ishim me dhjetëra gazetarë që kërkohet të flisnin me mua. Por, ti je aq i pafytyrë sa dole në TV, për t'i bërë reklamë vetes në emrin tim dhe gjenjeve duke thënë se më kishe ofruar të më çoje në Australi. Kurrë nuk më ke ofruar një gjë të tillë apo të kem folur me ty ditën që jam dorëzuar, që më tepër të kem kërkuar të njoftosh mediat. Me sa më kujtohet, të kam kthyer përgjigje vetëm me një mesazh, mesazheve të tua e telefonatave që bëje pa pushim si një servil i pështrirë që je, e tani që ndodhem i izoluar na bën si "trim", por një ditë do të dal nga këtu, edhe pse ti me tim vëlla po bëni çmos që të nglem këtu. Nuk e di a do mund të më mbrojnë policia apo edhe FBI po të vijë. Unë jam vetëdijues për të realizuar misionin tim, që i kisha ngarkuar vetes, të denoncimit dhe të zbardhjes së krimeve të politikës dhe atyre të Berishës në veçanti.

Jam vetëdijues për të mbajtur fjalën që kisha dhënë para publikut në shkurt të këtij viti, kur mora vesh vendimin për ekstraditim dhe këtë vendim e bëra publik para të gjithëve.

Nuk kam kërkuar as mbrojtje nga askush, as status dëshmitari të mbrojtur, kërkoh vetëm që të më krijohet mundësia që t'i denoncoj përpara drejtësisë, krimet e Berishës dhe klanit të tij mafioz e kriminal. Si përfundim, kisha edhe një mesazh për detyshen e batakçinjve e mashtroresve: Karaj - Haxhia, që të rreshtuar në krah të klanit kriminal të Berishës dhe të sponsorizuar me paratë e tij, që për këta të shitur nuk ka rëndësi nga vijnë, se për mua nuk ka rëndësi dy armiq më shumë, apo më pak. Po ua përsëris prapë se asgjë nuk mund të më lëkundë apo të më ndalojnë në misionin tim për të denoncuar krimet e Berishës, të cilin ju po i shërbeni me devotshmëri, si tradhtarë të pabesë e të shitur për një grusht para të pista. Asgjë nuk do më ndalojë të mbroj me çdo çmim dëshminë time, të cilën ju si burracak pervers, ju sulet me gjithë arsenalin tuaj të shpifjeve, sharjeve e kërcënimeve të denja vetëm për ju dhe "gjetarin dixhial" të Berishës.

Me respekt nga Izet Haxhia, burgu 302, kati 2, dhoma 21"
 Tiranë, më 7 tetor 2018.

NOJFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPERFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË D. PËLLUMB META DHE ZH.N. RITA META.

ÇMIMI 3.850.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 09.11.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

EPSA SHOQERIA PERMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NOJFTIM SHPALLJEN E ANKANDIT PER :

1- "Ndërtëse 3 Kat" pa truall, me vetem Kati i Pare i regjistruar në ZVRPP Tiranë me sip. 131 m² dhe Kati i Dytë dhe Kati i Tretë ndërtim pa leje", i ndodhur në Rr "Siri Kodra", Tiranë, Zona Kadastrale: 8340, Numri i Pasurisë: 4/171-ND, Vol.9, Faqe 127. Ky pasuri është hipotekuar në favor të **Fethi Kaya**. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **12.320.000 Lekë** . Ankandi zhvillohet datë **23.10.2018 ora 16.00** në adresën Rr."L. Qemali", Pall."Fratarit", K.6.Tiranë.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

SHOQERIA PERMBARIMORE GJYQESORE "3H" Sh.p.k
 Rr. "Flish Dalia", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë
 Web: www.3h.al, Email: shpgj.3h@yaho.com cel:0692099711

Nojfton shpalljen e ankandit nga **dt.11.10.2018 deri ne dt. 19.10.2018** per: sendin e luajtshem mjeti me targe AA 089 OB ne pronesi te Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M

Cmimi fillestar eshte 993 EURO

Ankandi zhvillohet ne zyrën permbarimore ne daten 19.10.2018 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00.

OSBE: Ja mangësitë në Shkodër e Vlorë. Ademi "sulmon" ish-kreun e bluve: Favorizoi hashashin!

Kultivimi i kanabisit, kryepërgjës: Jemi mes dy zjarreve, roga nuk na del as për këpucët

"Nga njëra anë na kërcënon shteti me burg, nga ana tjetër kriminelët që nuk të falin"

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Përfaqësues të dy prej qarqeve më problema tike për kultivimin e kanabisit, Shkodra dhe Vlora janë thirrur në një takim të përbashkët nga prezenca e OSBE në Shqipëri. Gjatë takimit që u zhvillua mbrëmjen e së enjtes në Shkodër, drejtorja në detyrë e OSBE-së, Katerine Kristesashvili u shpreh se institucionet vendore kanë pasur mangësi të njohurive për të luftuar kultivimin e kanabisit. Ajo tha se vendorët duhet të kontribuojnë në zhdukjen e qëndrueshme të kanabisit, duke dhënë një mesazh të qartë për eliminimin e këtij fenomeni. Në këtë takim ishin të pranishëm drejtues të policive të dy qarqeve, kryebashkiakja, Voltana Ademi si dhe kryepërgjës të Shkodrës e të Vlorës. Gjatë fjalës së tij, kreu i policisë Shkodër, Vehbi Bushati e quajti 2018-ën si vitin me rezultatin më të mirë në 20 vite në luftën antiknabis. Ndërkohë, kryetarja e Bashkisë së Shkodrës "sulmoi" ish-drejtorin e policisë së këtij qarqui se ka favorizuar kultivimin e hashashit. "Alban Çela nuk kishte aspak vullnet për të luftuar drogën në Shkodër. Po të ishte ai drejtor policie, s'do kishte çfarë t'i bënte as OSBE, as në të gjithë këtu dhe askush tjetër, dhe kultivimi do vazhdohe të rritej tepër, prandaj vullneti ka shumë rëndësi", deklaroi Ademi. Ndërkohë, një nga kryepërgjës të Vlorës ka deklaruar se jetojnë nën kërcënimin e kriminelëve që merren me kanabisin, ndërsa vazhdojnë të paguhen me rrogë qesharake, prej 49 mijë lekësh të vjetër në muaj.

DREJTUESHA E OSBE
Katerine Kristesashvili tha në takim: "Në vitin 2017 OSBE në Shqipëri ka ndihmuar Ministrinë e Brendshme dhe Task Forcën Qendrore për luftën antiknabis në realizimin e faktorëve shtytës për të forcur njohuritë në komunitetet vendore si dhe në bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel komunitar. Pra, mangësia e njohurive në komunitetet vendore si dhe bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional janë renditur si mangësitë më të mëdha për luftën ndaj këtij fenomeni."



Drejtoresha e OSBE-së, Katerine Kristesashvili



Takimi antiknabis në Shkodër

MANGËSITË

"Mangësia e njohurive në komunitetet vendore si dhe bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional janë renditur si mangësitë më të mëdha për luftën ndaj këtij fenomeni. Për të adresuar këto mangësi, OSBE ka ndihmuar Shkodrën dhe Vlorën në 2018-ën, në zbatimin e ndërgjegjësimit kundër kanabisit dhe ngritjen e planeve vendore dhe rajonale", tha drejtoresha e OSBE-së, Katerine Kristesashvili.

AKUZA E VOLTANËS

Kryebashkiakja Voltana Ademi nuk nguroi të akuzojë ish-drejtorin e policisë, Alban Çela se nuk ka pasur vullnet të luftojë kultivimin e kanabisit. "Alban Çela nuk kishte aspak vullnet për të luftuar drogën në Shkodër. Po të ishte ai drejtor policie, s'do kishte çfarë t'i bënte as OSBE, as në të gjithë këtu dhe askush tjetër dhe kultivimi do vazhdohe të rritej tepër", deklaroi Ademi.

KËRKESA E KRYEPËRGJËS

Islam Islami, kryepërgjës i fshatit Shkozë në Vlorë u shpreh se kryepërgjës jetojnë nën kërcënimin e kriminelëve, që merren me kanabisin ndërsa kërkoi që kryepërgjës të kenë një pagë të rregullt dhe jo pagesë qesharake prej 49 mijë lekësh të vjetër në muaj. "Ne deri tani kemi qenë mes dy zjarreve, nga njëra anë policia që na arrestonte dhe nga ana tjetër nën kërcënimin e kriminelëve", tha Islami.

BILANCI NGA PEFREKTURA

"Policia vendore e Shkodrës gjatë këtij viti (deri më tani) ka asgjësuar 88 paracela me kanabis dhe 3841 bimë narkotike që ishin të kultivuara. Krahasuar me 2017-ën, ka katër herë më pak bimë narkotike të asgjësuar, ndërsa është e pakrahasueshme me 2016-ën, vit në të cilin kanabisit lulëzoi, sepse në atë kohë ishte 106 herë më shumë se tani", tha përfaqësuesi i Prefekturës së Shkodrës, Ndue Molla.

Për të adresuar këto mangësi, OSBE ka ndihmuar Shkodrën dhe Vlorën në 2018-ën në zbatimin e ndërgjegjësimit kundër kanabisit dhe ngritjen e planeve vendore dhe rajonale". Më tej, drejtoresha e OSBE-së u shpreh: "Është e rëndësishme që përfaqësuesit e Task Forcës të analizojnë në mënyrë të përbashkët rezultatet e dala dhe të ndajnë eksperiencën në mënyrë të tillë që të kontribuojnë në zhdukjen e qëndrueshme të kultivimit të drogës. Identifikimi dhe zbatimi i këtyre veprimeve të qëndrueshme çon në avancimin e përmirësimit të situatës në zonat që ishin ose janë problematike".

KRYEBASHKIAKJA VOLTANA ADEMI
Kryetarja e Bashkisë Shkodër, Voltana Ademi tha se ka qenë mosbesuesja ndaj policisë, ndërsa u shpreh se parvarësisht rezultateve pozitive në 2018-ën, ende ka probleme. "Kam qenë mosbesuese ndaj

Policisë së Shtetit në dy vitet e fundit për shkak të situatës problematike nga kultivimi i kanabisit. Tashmë duhet thënë se për 2018-ën rezultatet janë pozitive dhe situata është përmirësuar, por nga ana tjetër sërish grupet kriminale tentojnë të veprojnë në terren dhe kjo punë nuk duhet të ndalet, deklaroi kryebashkiakja. Ndërkohë, Ademi dha disa propozime se çfarë duhet të ndryshojë për policinë, ndërsa nuk nguroi të akuzojë ish-drejtorin e policisë, Alban Çela se nuk ka pasur vullnet të luftojë kultivimin e kanabisit. "Unë them se infrastruktura për policinë është shumë e dobët dhe e kam fjalën për makinat e policisë që kanë probleme në zonat malore, flas për veshjen e efektivëve që duhen në mal apo gjëra të tjera të këtij lloji. Mjetet zbuluese duhet të jenë të shumta dhe bashkëkohore, duhet të kemi sensibilizim më të madh, edhe pse Bashkia Shkodër është

munduar që ta bëjë. Duhet të kujdesemi, sepse në kontrollim për territorin jashtë, por tashmë kemi parë se droga kultivohet edhe në mjedise të mbyllura dhe mund të mbillet edhe në pallate. Duhet të punojmë më shumë me të rinjtë vullnetarë, sepse droga është e përhapur edhe në shkollat tona. Pastaj e rëndësishme është që policia të ketë vullnetin e duhur se ndryshe nuk arrihet. Dua të përmend rastin e ish-drejtorit të policisë Shkodër, Alban Çela, i cili nuk kishte aspak vullnet për të luftuar drogën në Shkodër dhe po të ishte ai drejtor policie s'do kishte çfarë t'i bënte as OSBE, as në të gjithë këtu dhe askush tjetër dhe kultivimi do vazhdohe të rritej tepër, prandaj vullneti ka shumë rëndësi", deklaroi Voltana Ademi.

KRYEPËRGJËS
Gjatë takimit ishin të pranishëm edhe kryepërgjës të dy qarqeve. Njëri prej tyre,

Islam Islami, kryepërgjës i fshatit Shkozë në Vlorë u shpreh se kryepërgjës jetojnë nën kërcënimin e kriminelëve që merren me kanabisin, ndërsa kërkoi që kryepërgjës të kenë një pagë të rregullt dhe jo pagesë qesharake prej 49 mijë lekësh të vjetër në muaj. "Ne deri tani kemi qenë mes dy zjarreve, nga njëra anë policia që na arrestonte nëse nuk tregonim dhe nga ana tjetër nën kërcënimin e kriminelëve, të cilët nuk pyesin, por veprojnë dhe ju duhet të dini se ne kemi familje apo të afërm. Ne kemi ecur nga 6-7 orë në këmbë dhe se di sa këpucë kemi prishur dhe a e dini ju se paga jonë është 49 mijë lekë të vjetër. Çfarë të bëjmë me ato para që nuk dalin as për këpucët. Ne vendosim firmat tona në çdo procesverbal dhe puna jonë nuk vlerësohet. Këto gjëra duhen parë", tha kryepërgjës vlonjat.

SHKURT

Sekuestrohet drogë, lëndë plasëse e municione, kapet i riu

KURBIN - Policia e Kurbinit ka sekuestruar dje një sasi droge, lëndë plasëse, municione luftarake, ndërsa ka vënë në pranga poseduesin e tyre. Burime zyrtare pohuan se pas hekurave përfundoi Zef Marku, 34 vjeç, banues në Fushë-Mamurras. Të njëjtat burime sqaruan se blutë e Kurbinit në bashkëpunim me ata të Lezhës ushtruan kontrolle të befasishme në lokale, akse rrugore dhe ambiente të ndryshme, ndërsa u shpëruan për verifikim 10 persona. Ata janë kryesisht persona me precedentë penalë për armëmbajtje pa leje, vjedhje dhe prodhim e shitje të lëndëve narkotike.

Tentativë vrasjeje e drogë, arrestohen 2 persona në kërkim

MALLAKASTËR - Efektivët blu kanë zbuluar në terren për kapjen e personave të shpallur në kërkim. Kështu, në sajë të një operacioni të kryer nga policia e Mallakastrës dhe drejtoria vendore e Fierit e mbështetur nga FNSH kanë bërë kontrolle të befasishme në lokale e akse rrugore për kapjen e personave të shpallur në kërkim. Burime zyrtare thanë se janë shoqëruar për verifikim 8 persona me precedentë penalë. Ndërkohë, në pranga ranë dy persona, që ishin shpallur në kërkim. Konkretisht u ndaluan shtetasit Fatmir Merkaç, 26 vjeç, banues në Kutë dhe Muharrem Saliaç, 65 vjeç, banues në Fier. Merkaç ishte shpallur në kërkim për tentativë vrasjeje, për të cilën Gjykata e Fierit e ka dënuar me 6 vite burg. Kjo pasi ai në datën 20.08.2016, në fshatin Kutë, për motive të dobetë ka tentuar të vrasë me armë zjarri shtetasin T.A. 40 vjeç, Sakaç, Saliaç u ndalua për llogari të Policisë së Gjirokastrës, pasi ishte në kërkim për trafik narkotikësh.

Sherr me thika mes të rinjve, prangosen autori dhe i lënduari

MEMALIAJ - Një sherr me thika në Memaliaj ka përfunduar me plagosjen e një të riu. Burime nga policia lokale pohuan se u arrestua Klevis Saka, 20 vjeç, pasi ka kanosur me thikë e dëmtuar lehtë Klajdi Dervishin. Gjithashtu, është arrestuar edhe ky i fundit, pasi ka goditur me sende të forta Sakën si dhe ka thyer xhamin e parë të autometit në pronësi të këtij shtetasi. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë për veprime të mëtejshme.

Varrosen tre viktimat. I mbijetuari: Babai i njërit prej të vrarëve qerasi me raki Koxhajn

Masakra në Mat, autori policëve: Më jepni bukë të mbush barkun, se jam shumë i uritur

"Vrasja..., njëri nga ata më fyeu dhe më qëlloi me shuplakë, ndaj qëllova, më pas nuk mbaj mend çfarë ndodhi"

Enver Doçi

MAT

Më jepni njëherë bukë të mbush barkun se jam shumë i uritur, pastaj flasim se përse e bëra vrasjen". Këto kanë qenë fjalët e para që ka thënë në komisariatin e policisë së Burrelit, kryeplaku i fshatit Shëlli, Kujtim Koxha, i cili dy ditë më parë bëri masakër, duke vrarë me kalashnikov tre punonjës së Bashkisë së Matit dhe duke plagosur një tjetër. I pyetur se përse e bëri vrasjen e trefishtë që tronditi banorët e zonës dhe të gjithë opinionin publik, 51-vjeçari u ka kërkuar të mbush barkun me bukë. Ndërsa, i kanë thënë se do t'i caktonin një avokat, ai është shprehur se "avokatin e gjej vetë". Më pas, gjatë marrjes në pyetje nga hetuesit e çështjes, autori i ngjarjes së rëndë është justifikuar me fjalët se njëri nga viktimat e kishte fyer dhe e kishte qëlluar me shuplakë. "Njëri nga ata më qëlloi në shuplakë dhe më tha je i dehur. Më pas nuk mbaj mend se çfarë ka ndodhur", është shprehur 51-vjeçari, i cili pohohet të jetë person problematik. Më pas, Kujtim Koxha ka treguar se pas debateve për rrugën me punonjësit e bashkisë ka shkuar në shtëpi, 500 m larg lokalit ku po drekonin dhe ka marrë automatikun. Burime nga grupi hetimor bënë me dije se në vendin e ngjarjes u gjendën 11 gëzhoja, pasi kryeplaku i fshatit ka qëlluar me breshëri. Një nga të pranishmit ka tentuar t'ia heqë armën nga dora, pasi Koxha tentoi të vriste të gjithë ata që ndodheshin në lokal. Ndërkaq, mesditën e djeshme iu është dhënë lamtumira e fundit viktimave: Mentor Hoxha 36 vjeç, Erzen Aliaj 49 vjeç dhe Hamit Buçi. Ceremonitë e varrimit janë bërë në tri fshatra. Kjo për faktin se viktimat jetonin në fshatra të ndryshme, konkretisht në Zonisht, Burgajet, Shëlli. Në varrimin e viktimave kanë marrë pjesë qindra njerëz, stafi i Bashkisë së Matit si dhe përfaqësues të PD-së, PS-së si dhe deputeti i LSI-së, Përparim Spahiu. Pasditën e djeshme ka mbërritur në Mat dhe kreu i PD-së, Lulzim Basha, i cili ka vizituar dhe ka ngushëlluar familjarët e tre të vrarëve. Gjithashtu, Basha ka qenë edhe në spitalin e Burrelit ku ka vizituar 40-vjeçarin Astrit Hani, i cili mbeti i plagosur, duke i mbijetuar masakrës.



51-vjeçari Kujtim Koxha, autori i masakrës në Mat



Ceremonia e varrimit të viktimave

VRASËSI

Një ditë pas vrasjes së trefishtë janë zbardhur detaje të tjera rreth ngjarjes. Mësohet se kryeplaku Kujtim Koxha ishte një person problematik në fshatin e tij. Raportohet se para disa ditësh, 51-vjeçari kishte qenë në spital, pasi ishte plagosur me thikë nga vëllai i tij pas një konflikti. Kujtim Koxha kishte qëndruar i shtruar për disa ditë në spitalin e Burrelit.



Lokali ku ndodhi vrasja e trefishtë

kolegët e tij dhe atë vetë. **DËSHMIA E TË MBIJETUARIT** Astrit Hani tha se dy orë para ngjarjes, autori i krim-it kishte pirë raki me një nga viktimat, Hamit Buçin. Hani shokoi me dëshminë e tij, pasi pohoi se ndërsa babai i një prej viktimave, (Mentor Hoxhës), i kishte lënë porosi pronarit të lokalit që ta qeraste Koxhën me një gotë raki nga ana e tij. "Kujtimi ishte dy orë para ngjarjes në atë lokal. Ishte ulur bashkë me Hamit Buçin. Pak më vonë, babai i njërit prej viktimave, Mentor Hoxhës, e qerasi me një dopio raki Kujtimin dhe më pas u largua. Aty ishin të gjithë punonjësit e bashkisë, edhe shoferët e makinave dhe varrmihës që po punonin për rrugën. Unë isha poshtë makinës (shoferi i një prej mjeteve të bashkisë)

se po e shihja një defekt dhe pashe që Kujtimi po debatoje me viktimat. Dëgjova që u thoshte: "Jam unë këtu, jo ju" dhe kur iku, i ofendoi. Madje ai tha "do ta shihni për pak se kush jam unë", - tha i mbijetuari. Më tej, Hani pohoi se gjithçka ndodhi gjatë kohës që ata ishin të gjithë duke ngrënë drekë. "Koxha u largua për 20 minuta nga lokali, se aq siç duket e kishte shtëpinë larg prej aty. U fut në derë me automatik dhe një çantë në dorë. Të parin qëlloi Mentor Hoxhën dhe më pas hapi zjarr me automatik te të tjerët. Vëllai i pronarit të lokalit që ishte te banaku, pas dere, e kapi nga duart dhe i ngriti automatikun lart dhe plumbat prekën tavanin. Po mos të kishte qenë, ai do ishin 13 viktimat brenda në lokal", deklaroi 40-vjeçari Astrit Hani.

CEREMONIA E VARRIMIT

Mesditën e djeshme iu është dhënë lamtumira e fundit viktimave Mentor Hoxha 36 vjeç, Erzen Aliaj 49 vjeç dhe Hamit Buçi. Ceremonitë e varrimit janë bërë në tri fshatra. Kjo për faktin se viktimat jetonin në fshatra të ndryshme, konkretisht në Zonisht, Burgajet, Shëlli. Në varrimin e viktimave kanë marrë pjesë qindra njerëz, stafi i Bashkisë së Matit si dhe përfaqësues të PD-së, PS-së si dhe deputeti i LSI-së, Përparim Spahiu.

BASHA NË MAT

Vrasja e trefishtë që ndodhi dy ditë më parë në fshatin Shëlli dhe që tronditi opinionin publik ka çuar pasditën e djeshme në Mat kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Bashën. Mësohet se kryedemokrati ka vizituar dhe ka ngushëlluar familjarët e tre të vrarëve. Gjithashtu, Basha ka qenë edhe në spitalin e Burrelit, ku ka vizituar 40-vjeçarin Astrit Hani, i cili mbeti i plagosur, duke i mbijetuar masakrës.

Flet brigadieri: Vrasja, jo për shkak të rrugës

"Kujtim Koxha donte të na vriste të gjithëve në lokal, ia morën automatikun nga dora"



Brigadieri Gëzim Hoxha

MAT - Pas vrasjes së trefishtë në Mat, dje ka folur edhe brigadieri i ndërmarrjes, Gëzim Hoxha, i cili ka dhënë detaje të reja për "masakrën" e kryer ndaj punonjësve të bashkisë. Ai ka thënë se Kujtim Koxha do i vriste të gjithë personat që ndodheshin në lokal, nëse nuk do ia kishin larguar armën nga dora. Gjithashtu, brigadieri u shpreh se shkaku i vrasjes nuk ka të bëjë me 10 metrat e rrugës, siç është raportuar në media, pasi ishte në plan që të rregulloheshin të gjitha rrugët e fshatit Shëlli. Ndërkaq, Hoxha ka treguar se 51-vjeçari ka hyrë i armatosur me automatik në lokal. "Shoferët shkuan me makinë 15 minuta para, ndër-

itë, rreth orës 08:00 ishim në fshat. Për Kujtim Koxhën na thanë që kishte tërë ditën në lokal. Atë nuk e njihnim, s'kemi pasur kontakt me të. Kërkesa për 10 metra rrugë është gënjeshtër. Koxha me Hamit Buçin ishim shokë. Hamit Buçi ishte te banaku, nuk ishte me ne", sqaroi Gëzim Hoxha. Gjithashtu, brigadieri i ndërmarrjes u shpreh se nuk është në dijeni për faktin nëse Koxha ka pasur debate të mëparshme me shoferët. Vrasja në Mat ka shkaktuar debate të shumta në opinionin publik, ndërsa bashkia vendosi pasditën e së enjtes t'u akordojë titullin "Nderi i Matit" tre punonjësve, të cilët humbën jetën në krye të detyrës.

AKU hap tenderin 6.1 milionë lekë për aparatet inspektuese

Kontrolle të specializuara për cilësinë e vajit në restorante dhe fast-food-e



Së shpejti do të nisim kontrolle të specializuara për cilësinë e vajit që përdorin restorantet dhe fast food-et në vend. Kështu Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, nëpërmjet një procedure të hapur tenderuese, ka vënë në dispozicion një fond limit prej 6.1 milionë lekësh, që do të përdoret për blerjen e pajisjeve speciale për grupet e inspektimit të drejtorive rajonale të AKU. Përkatësisht kërkohet blerja e aparateve matës për caktimin e cilësisë së vajit për skuqje si dhe kite për mar-

6.1

MILIONË LEKË
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, nëpërmjet një procedure të hapur tenderuese, ka vënë në dispozicion një fond limit prej 6.1 milionë lekësh, që do të përdoret për blerjen e pajisjeve speciale për grupet e inspektimit të drejtorive rajonale të AKU.

rje mostrash të ngurta dhe të lëngëta. Kjo masë vjen pas alarmeve të herë pas herëshme që kanë dhënë ekspertët e ushqimit dhe të

mbrojtës së konsumatorit, kryesisht në drejtim të vajit të që përdoret nga fast food-et. Sipas tyre, vaji që përdoret masivisht nuk reko-

mandohet të përdoret më shumë se 4-5 herë, por pavarësisht kësaj në këto biznese përdorimi i tij mund të shkojë edhe më javë. Ky abuzim, sipas ekspertëve, shkakton probleme serioze në shëndet, që lidhen me alergjitë në aparatit tretës, zmadhim të mëlçisë apo zmadhim të pankreasit. Gjithashtu, disa studime kanë treguar se këto simptoma shkaktojnë edhe kancer në rast se teprohet me përdorimin e këtyre produkteve. Ofertat nga kompanitë

e interesuara për të marrë pesë në garën e shpallur nga AKU do të pranohen deri në datën 24 tetor, çka do të thotë se nisja e inspektimeve më të specializuara nuk do të vonojë.

Në kuadër të sigurisë ushqimore dhe monitorimit të të gjithë operatorëve të biznesit ushqimor (OBU) pranë institucioneve arsimore në vend (shkolla, kopshte, çerdhe) AKU ka kryer në rang

vendi 227 inspektime. Deri më tani nga AKU janë marrë: 65 masa administrative me paralajmërim, 13 masa administrative me gjobë në vlerën 1 720 000 lekë si dhe dy ndërprerje aktiviteti. Ndërkohë gjatë inspektimeve, janë dhënë edhe këshillime ndaj subjekteve duke bërë të mundur eliminimin e problemeve që mund të konstatohen nga produktet ushqimore.

Studimi i INSTAT/ Nga 37 mijë klasa, përfundojmë me rreth 11 mijë të tilla


Shifrat alarmante, sistemi arsimor reduktohet me 35%

Në gjimnaze ka shumë nxënës e pak mësues

Raporti i nxënësve për mësues ka shënuar një rënie të konsiderueshme krahasuar me vitet më parë, çka do të thotë se në vendin tonë ka pak mësues për të përballuar nxënësit e gjimnazeve. Sipas statistikave më të fundit nga INSTAT, për vitin mësimor 2017-2018, treguesi i raportit nxënës për mësues ishte 13.8, duke e renditur kështu Shqipërinë si vendin e parë në rajon që ka raportin më të lartë të nxënësve për mësues dhe madje edhe në Europë është ndër shtetet problematike. Nga të dhënat e Eurostat, në gjimnaze llogariten mesatarisht 11.8 nxënës për çdo mësues për mesataren e BE, ndërsa në Serbi rreth 8.3. Në krahasim me vendet e Bashkimit Europian, Shqipëria renditet ndër vendet e para që ka raport të lartë të nxënësve për mësues. Sipas të dhënave të publikuara nga Eurostat për vendet e BE-së dhe INSTAT për Shqipërinë, në shkollat e mesme në vend ka 2 nxënës më shumë për çdo mësues se në Europë. Në të gjithë Bashkimin Europian numërohen rreth 1.8 milionë mësues në gjimnaze. Zakonisht studentët në Bashkimin Europian ndjekin studimet për programet dytësore të studimit (gjimnazet) në moshën 14-16 vjeç. Në përgjithësi këto programe përgatisin nxënësit për studimet universitare apo ju mundësojnë aftësitë të vlefshme për punësim. Raportin më të lartë të nxënësve për mësues e kishte Holanda, ku sipas të dhënave që ka publikuar Eurostatat për çdo mësues kushte 17.9 nxënës. Më pas renditet Finlanda ku sipas të dhënave raportit ishte 17.2, Mbretëria e Bashkuar me 16.5. Ndërsa raportit më i ulët ishte në Lituanë, ku kishte mesatarisht për çdo mësues 7.7 nxënës, Maltë me 8.3 nxënës për mësues dhe Luk-

Ministria Manastirliu: Shërbimi i plotë për kancerin e gjirit në Durrës

Në spitalin rajonal të Durrësit ofrohet për herë shërbimi i plotë për sëmundjet e gjirit, duke filluar nga diagnostikimi, vendosja e diagnozës, shërbimi kirurgjikal, trajtimi dhe kujdesi paliativ. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu inauguroi dje Njësinë e re të Senologjisë në spitalin e Durrësit, e shoqëruar nga ekipi i mjekëve të QSUT dhe deputetet e zonës. "Ngritja e Njësisë së Senologjisë në spitalin e Durrësit, e para në një spital rajonal (pas QSUT) mundëson ofrimin e të gjithë ciklit të shërbimeve, 360 gradë, brenda këtij spitali, duke ofruar për herë të parë shërbimin e plotë afër vendbanimit për të gjithë qarkun e Durrësit, në mënyrë që gratë me kancer gjiri të mos kenë nevojë t'i drejtohen QSUT qoftë për konfirmimin e diagnozës apo për trajtimin e mëtejshëm të saj", tha Manastirliu. Njësia e re u mundësua falë investimeve në pajisje mjekësore, por, edhe kualifikimit të ekipit të mjekëve të spitalit të Durrësit për ofrimin e shërbimit të plotë për sëmundjet e gjirit. Njësia e re e Senologjisë në spitalin e Durrësit, e pajisur me të gjithë aparataturat e nevojshme, mundëson krijimin e një bërthame të re në fushën e Onkologjisë, e cila për herë të parë do të mundësojë një konsultë multifunkionale që do të përbëhet nga mjekë të specialiteteve të ndryshme.



260

MIJË NXËNËS MË PAK

Rënia më e madhe ishte në arsimin 9-vjeçar, ku këtë vit janë ulur në bankat e shkollës 260 mijë nxënës më pak se në vitin 1991. Vetëm në dy vitet e fundit, shkollën e vijuan 46 mijë fëmijë më pak. Rënia e numrit të nxënësve është shoqëruar edhe me reduktim të trupës arsimore.

semburg me 9 nxënës për mësues. Eurostat ka sqaruar se raportit nxënës për mësues përllogaritet duke pjesëtuar numrin e nxënësve me kohë të plotë me numrin e mësuesve që japin mësim në gjimnaze me kohë të plotë. Ky raport nuk duhet ngatërrues me klasat mesatare, duke qenë se nuk merr në konsideratë klasat e veçanta. Raporti nxënës për mësues mat numrin e nxënësve që studiojnë në shkollat e mesme për një mësues. Në vitin shkollor 2013-2014, ky raport sipas INSTAT

ishte 17 nxënës për një mësues, ndërkohë që numri i studentëve të regjistruar ishte mbi 151. Megjithatë vit pas viti numri i nxënësve që janë të regjistruar në arsimin e mesëm ka njohur turrje të vazhdueshme, ndërsa niveli i mësuesve ka ndryshuar pak. Nga viti mësimor 2013-2014 në vitin 2017-2018 janë regjistruar në gjimnaze 31 mijë e 800 nxënës më pak. Rënia e raportit ka ardhur si pasojë e pakësimit të nxënësve nëpër gjimnaze. **REDUKTIMI** Sektori i arsimit është

reduktuar më shumë se 30% që nga viti 1990 si në numrin e nxënësve, mësuesve dhe shkollave. Sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT, numri i nxënësve që ndjekin arsimin e 9-vjeçar dhe të mesëm ra në 43 mijë e 700 nxënës në vitin 2018 nga 68 mijë e 600 nxënës që ishin në vitin 1991, ose 35% nxënës më pak. Rënia më e madhe ishte në arsimin 9-vjeçar, ku këtë vit janë ulur në bankat e shkollës 260 mijë nxënës më pak nxënës se në vitin 1991. Vetëm në dy vitet e fundit, shkollën e vijuan 46 mijë fëmijë më pak. Rënia e

numrit të nxënësve është shoqëruar edhe me reduktim të trupës arsimore. Në vitin 1991, numëroheshin 43700 mësues në të gjithë vendin, ndërsa në fillim të këtij viti, numri i tyre ishte 29000, me turrje 33% që nga viti i parë i tranzicionit. Gjithashtu, numri i shkollave u ul me 35% që nga viti 1991. Shqipëria hyri në periudhën e tranzicionit me 2200 shkollat të arsimit 8-vjeçar dhe të mesëm, këtë vit dhe me 1134 shkollat. Afërsisht, 150 shkollat u mbyllën vetëm këtë vit, për shkak se numri i nxënësve po bie në mënyrë të frikshme në disa qarqe të vendit. Numri i klasave është reduktuar më tej. Nga 37 mijë klasa që ishin në fillim të viteve 1990, aktualisht janë rreth 11 mijë klasa. Numri i tyre është reduktuar me 70% përgjatë 28 viteve.

EMIGRANTËT NË GREQI PASAPORTA HELENE

Ndërmjetësi në Ministrinë e Emigracionit: Lehtësirat në projektligjin e ri

Fatos Malaj: Nënshtetësia greke, si mund të informoheni për fazën e aplikimit

"Procedura për marrjen e pasaportës helene"

Voltiza Duro

Të gjithë emigrantët shqiptarë që jetojnë në Greqi e kanë aplikuar për nënshtetësinë helene tashmë mund të informohen shumë lehtë mbi fazën e marrjes së pasaportës greke. Ky lajm bëhet me dije për 'Gazeta Shqiptare' nga Fatos Malaj, ndërmjetës ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit, njëkohësisht drejtues i organizatës së emigrantëve "Arogji - Përkrhaja". Marrja e këtij informacioni mbi fazën e aplikimit të nënshtetësisë greke është vetëm një telefonatë larg. "Gjithë personat që kanë aplikuar për nënshtetësinë greke dhe duan të pyesin se në ç'fazë ndodhet aplikimi i tyre, tashmë mund të telefonojnë direkt në drejtorinë e nënshtetësisë të Ministrisë së Brendshme. Siç bën të ditur zyra e shtypit e ministrisë, numri i telefonit ka nisur të funksionojë para disa ditësh", thekson Malaj për 'Gazeta Shqiptare'. Në njoftimin e Ministrisë së Brendshme greke bëhet me dije se me krijimin e zyrës së shërbimit telefonik do të përmbyshen nevojat e të interesuarve për komunikim dhe informim, lidhur me ecurinë e kërkesës së tyre për natyralizim. "Të interesuarit mund të telefonojnë nga e hëna në të premte (me përjashtim të pushimeve zyrtare), dhe nga ora 10,00 deri 13,00, në numrin e telefonit: (+30) 2131361919", nënvizohet në njoftim. Ndërkohë një tjetër mënyrë e shpejtë për të marrë informacion mbi fatin e aplikimit për pasaportën greke është edhe nëpërmjet shërbimit të internetit. "Rruga tjetër për të mësuar mbi aplikimin, është interneti. Të interesuarit mund të klikojnë në faqen zyrtare të ministrisë së brendshme, ku në fund djathtas te kutia rozë, me emrin "POREIA KTISIS ITHAJENIAS - Ecuria e marrjes së nënshtetësisë" dhe të ndjekin udhëzimet. Pra të klikojnë shërbimin ku e kanë dorëzuar aplikimin në bazë të qarkut, numrin e dosjes, emrin, mbiemrin, si dhe të shkruajnë simbolet e verifikimit në fund fare e pastaj shtypin "ANAZITISI".



Fatos Malaj, ndërmjetës ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit

INFORMIMI

"Të gjithë personat që kanë aplikuar për nënshtetësinë greke dhe duan të pyesin se në ç'fazë ndodhet aplikimi i tyre, tashmë mund të telefonojnë direkt në Drejtorinë e Nënshtetësisë të Ministrisë së Brendshme. Siç bën të ditur zyra e shtypit e ministrisë, numri i telefonit ka nisur të funksionojë para disa ditësh", thekson Malaj



LEJET E QËNDRIMIT

"Kemi arritur që brenda një viti të sjellim lajme të mira edhe për emigrantët që aplikojnë për leje qëndrimi për arsye të jashtëzakonshme. Të gjithë ata që kanë jetuar në shtetin helen ilegalisht për më shumë se 7 vjet dhe dëshirojnë të marrin leje qëndrimi, procedura do të thjeshtëzohet", thekson ndërmjetësi.

PROCEDURA DHE KRITERET

Si mund të merret nga të gjithë nënshtetësia Greke:

- Nëse jeton 7 vjet ligjërisht në Greqi
- Nëse jeton 3 vjet rresht në Greqi dhe ke ardhur nga një vend i Bashkimit European
- Nëse je homogjen
- Nëse je refugjat politik
- Nëse ke buletin personi pa shtetësi
- Nëse ke një fëmijë, i cili është shtetas grek

Kërkesat formale për marrjen e shtetësisë greke me natyralizim

- Ju duhet të jeni në moshë madhore në kohën e deklaramit të natyralizimit.
- Të mos jeni dënuar me burgim të përvetshëm (përfundimtar), të paktën një vit në dekadën e fundit.
- Të mos jetë në pritje një vendim deportimi (apelasi) kundër jush.
- Të kemi titull qëndrimi të ligjshëm.

MARRJA E NËNSHTEËSISË

Prej disa kohësh, Greqia ka lehtësuar procedurat për të gjithë emigrantët shqiptarë që marrin nënshtetësinë greke. I pyetur nga 'Gazeta Shqiptare', Fatos Malaj, tregon se procedura

për kryerjen e shkëputjes nga leja e qëndrimit, mund të kryhet automatikisht. "Në momentin që një emigrant shqiptar merr nënshtetësinë greke, kjo paraqitet në gazetën qeveritare. Para funksiononte në këtë mënyrë: emigranti duhej të

Aplikimi

Të interesuarit mund të klikojnë në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme, ku duhet të klikojnë shërbimin ku e kanë dorëzuar aplikimin në bazë të qarkut, numrin e dosjes, emrin, mbiemrin, si dhe të shkruajnë simbolet e verifikimit në fund fare e pastaj shtypin "ANAZITISI".

TË DHËNAT

shkonte në Qendrën e Emigracionit ku dhe kishte marrë lejen e qëndrimit, dhe bënte shkëputjen nga kjo leje në mënyrë që të merrte nënshtetësinë. Por kjo ishte një procedurë që zgjaste 2-3 javë. Tashmë procedura është lehtësuar dhe bëhet automatikisht", thotë Malaj. Megjithatë heqja e lejes së qëndrimit mund të duket një veprim i thjeshtë, në fakt, njerëzve u kushton shumë, sidomos të rinjve të brezit të dytë që mund të kishin shans për të shfrytëzuar programe studimi jashtë shtetit, dhe nuk pajiseshin në kohën e duhur me këtë dokumente greke. Kjo sepse nuk mund të paraqiteshin direkt në zyrat e shtetasve të huaj dhe emigracionit, por duhej që më parë të linin një takim i cili mund të realizohej edhe pas disa muajsh. Ndërkaq edhe

mbajtësit e "kartës së homogjenit", duhej të paraqiteshin në polici për të anuluar kartën e tyre. Pra, gjithë kjo procedurë sillte një zvarritje të panevojshme, në një kohë që gjithçka mund të zgjidhej në mënyrë elektronike nga shërbimet administrative greke. Fatos Malaj ishte i pari që e përcolli këtë sqetësim, dhe me mbështetjen e Ilias Hronopulos, arriti ta bindte administratën greke për ndryshim që duhej të bënte. Ky ndryshim përshkruhet në shkresën që Ministria e Rendit i ka dërguar shërbimit të letërnjoftimeve dhe pasaportave dhe zyrave përkatëse në të gjithë vendin. Edhe pse dy vendime ministrore (2012 dhe 2014), parashikonin që kërkesa për nxjerrje letërnjoftimi duhej shpërndarë nga dorëzimi i lejes

së qëndrimit apo i "kartës së homogjenit", shkresa përcaktonte: "Për nxjerrjen e letërnjoftimit nuk parashikohet paraqitja e vërtetimit për dorëzimin apo anulimin e lejes së qëndrimit apo Kartës së Posaçme të Homogjenit". Gjithashtu, ndërmjetësi ndërkulturor Malaj tregon për "GSH" se janë krijuar lehtësira edhe për emigrantët që aplikojnë për leje qëndrimi për arsye të jashtëzakonshme. "Kemi arritur që brenda një viti të sjellim lajme të mira edhe për emigrantët që aplikojnë për leje qëndrimi për arsye të jashtëzakonshme. Të gjithë ata që kanë jetuar në shtetin helen ilegalisht për më shumë se 7 vjet dhe dëshirojnë të marrin leje qëndrimi, procedura do të thjeshtëzohet. E para iu duhet të dorëzonin dokumente vërtetimi që këta emigrantë dëshmonin se kishin qëndruar në Greqi për më shumë se 7 vite, u përfshishin edhe kontratat e qirasë apo të punës. Tashmë kjo kategori emigrantësh duhet të dorëzojë vetëm vërtetimin që prej 7 vitësh jetojnë në shtetin fqinj", tregon Malaj.

PORTRET

IDLIR SHYTI

Një yll shqiptar në ngjitje
ndërkombëtare si violonçelist

Nga Vaso Tole*

Të mësuar me tingëllimin e emrave të mëdhenj të interpretimit muzikor ndërkombëtar me origjinë shqiptare si këngëtarët lirikë Ermonela Jaho, Saimir Pirgu, Enkelejd Shkoka; të violinistëve Tedi Paparavi, Kristi Gjezi, Klajdi Sahati apo të pianistëve aktiv si Dhurata Lazo, Desir Sulejmani, Marsida Koni, Maniola Camuset-Trebicka, Ida Dili, Elida Dakoli, Redi Lluqa etj., ndoshta ju ka shpëtu emri i Idlir Shytit, violonçelistit të talentuar shqiptar që zhvillon aktivitetin e tij artistik në Londër, i cili me siguri, do të përfshihet shumë shpejt në yllësinë e krenarisë sonë artistike me njohje ndërkombëtare.

Po cili është dhe çfarë e bën kaq të veçantë Idlirin?

Lindi në Elbasan më 26 mars 1991 në një familje me origjinë nga Korça. Kreu tetëvjeçaren për violonçel në shkollën artistike ONU-FRI dhe dy vite në Liceun Artistik "Jordan Misja" në Tiranë nën drejtimin e pedagogut Astrit Selita. Zotëron një formim solid si muzikant ku ndër të tjera përmendim se në prill të vitit 2018 u diplomua me titullin "Diplôme Supérieur de Concertiste" me Anssi Karttunen në École Normale de Musique de Paris; studimet e masterit i kreu në Royal College of Music në Londër

nën drejtimin e Richard Lester dhe ato bachelor në Conservatorio di Santa Cecilia në Romë, me Maurizio Gambini. Pra, Romë-Londër-Paris, një trekëndësh i artë për formimin e tij muzikor. Ka marrë pjesë në masterklase me violonçelistë të njohur botërore si: Yo-Yo Ma, Gary Hoffman, Wen Sinn Yang, Enrico Dindo, Giovanni Sollima, Johannes Goritzki, Jérôme Pernoo mes të tjerësh dhe masterklase në muzikë dhome me Sacconi Quartet, Gryphon Trio, Allegri Quartet etj. Aktualisht është duke punuar me Southbank Sinfonia në Londër.

Idlir Shyti ka interpretuar si solist me Südwestdeutsche Kammerorchester, Orchestra del Conservatorio di Santa Cecilia, Orkestra e Akademisë të Arteve, Southbank Sinfonia, Hounslow Symphony Orchestra dhe ka marrë pjesë në festivale si "Festival Atlanta Sonoro", "Rome Chamber Music Festival", "Cello Biennale", "Musica a Roma për Roma" në salla prestigjioze të muzikës si "Palazzo Barberini", "Salle Cortot", "Amaryllis Fleming Concert Hall", "King's Place",



Idlir Shyti

Artisti që po pushton
skenat e huaja me tinguj

"Charlton House". Si orkestrant ka performuar nën drejtimin e dirigjentëve të njohur si Gabor Takacs Nagy, Bernard Haitink, Jack van Steen, Nicholas Collon, Philippe Entremont, Brett Dean duke luajtur në salla prestigjioze si Royal Festival Hall, Queen Elisabeth

Hall, Saint-Martins in the Fields, Milton Court në Londër, Sheldonian Theatre në Oxford, Town Hall Birmingham, Leith Theatre Edinburgh, Théâtre de Champs Elysées në Paris, Konzerthaus Berlin.

Nga një dëgjim dhe vëzhgim i kujdesshëm i lojës së tij në violonçel konstaton

qartazi disa elemente, aq të domosdoshëm për ti pasur çdo muzikant interpretues i kalibrin.

Së pari, ndjeshmërinë e hollë muzikore, zotërimin tërësor të teknikave të lojës në violonçel, spektrin e gjerë të repertorit që luan, prej barokut deri në muzikën kontemporane bashkë me lehtësinë për të ndryshuar dhe përshtatur stilin e lojës me to. Një shtrirje gjeografike prej Evropës në

Azi e Amerikë e muzikës që interpreton është një tjetër shenjë (ndonëse e tërthortë) e kapacitetit intelektual përthithës që ai zotëron. Mjafton të dëgjoni prej tij Bahun, Shumanin, Cajkovskin, Masnenë, Rahmaninovin, Shostakoviçin, Respighin, Dusapenin, Tan Dunin etj. Thjesht e admiron për atë që ka arritur me punën dhe përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm.

Është e domosdoshme, por edhe e natyrshme që publiku shqiptar të njihet me arritjet e këtij talenti, i cili është, gjithashtu, në vazhden e emrave të mëdhenj të elitëve shqiptarë si Ymer Skënderi, Gjergj Antoniu, Gëzim Laro, Astrit Selita, Pjetër Guralumi etj., e sigurisht institucionet përkatëse dhe dashamirësit e muzikës të ndikojnë që artin e interpretimit të tij ta prekim e shijojmë edhe këtu në Shqipëri, në vendin e origjinës së tij, të cilën ai e ka të pandarë nga vetja. Sukseset të tjera Idlir në rrugën e gjatë që ka nisur. ***Kompozitor, akademik**

ICHIRO IURA, PËRKTHYESI I AUTORËVE
SHQIPTARË NË JAPONISHT

Studiuesin dhe albanologun e mirënjohur japonez, dr. Ichiro Iura, i cili, që pas hapjes së katredrës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Hiroshimës, ka arritur që falë një pune shumëvjeçare të përkthejë e të botojë një sërë vprash dhe shkrimtarësh më në zë të letrave shqipe dhe t'i bëjë të njohur falë përpjekjeve të vazhdueshme për publikun japonez. Kjo përbën jo vetëm një sukses, por edhe një tregues të pakundërshtueshëm për vlerat dhe rëndësinë që bart kjo letërsi në mozaikun dhe zhvillimet e letërsisë së gjithmbarshme. Tashmë, kultura e shkruar shqipe, po shfaqet gjithmonë e më e plotë edhe në gjuhën japoneze.

Veptrat e përkthyerat dhe të publikuara nga dr.



Ichiro Iura, janë si më poshtë: nga Ismail Kadare, "Dimri i vetmisë së madhe", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Ëndrra mashtruese", "Përbindëshi", "Nga një dhjetor në tjetrin", nga Dritëro Agolli "Kalorësi lakuriq", nga Xhevahir Spahiu "Pezull", nga Fatos Kongoli "I Humburi", nga Ylljet Aliçka "Parullat me gurë", nga Betim

Muço "Karusel" dhe "L & M", nga Ermir Nika "Net mëkatarësh" e nga Viktor Canosinaj "Meriyll".

Vlen të përmendet fakti se pas përkthimit të një fjalori japonez-shqip, me rreth 1000 fjalë, apo përkthimit dhe botimit të romanit "Qyteti i fundit", të shkrimtarit të shquar shqiptar Petro Marko, si dhe botimi në japonez të veprës së shkrimtarit të shquar shqiptar Ismail Kadare, veçanërisht romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", ka shënuar një sukses të jashtëzakonshëm për lexuesin japonez dhe, për më tepër, u vu re se kjo vepër kishte tërhequr interesin dhe vëmendjen kryesisht të gjeneratës së re, të përbërë nga nxënës e studentë dhe intelektualë të spikatur.

VIRION GRAÇI: KUR FATOS ARAPI NA
FLISTE PËR KADARENË E AGOLLIN

Pikërisht 30 vite më parë e kam takuar për herë të parë poetin Fatos Arapi. Rasti më çoi në Banësinë e tij, përballë liceut njëshoku im i kursit e kishte zgjedhur si udhëheqës shkencor për temën e diplomës, "Poezia e Podrimjes...". E kështu shkonim te F. Arapi". E kujton ende sot si atëherë, takimin e parë me poetin, shkrimtarin Virion Graçi. Vëren se "kureshtjet e tij ishin për shkrimet tona e kureshtjet tona ishin për atë vetë e për brezin e tij. Bisedonte shpenguar duke na trajtuar si djem të rritur, të besës, ndonëse në rrëfimet e tij për Kadarenë, Agollin e ndonjë tjetër kishte veçse respekt e fjalë nderuese. "Dhimbia për vëlënë varrumbur kish nisur t'i shpërfaqej pasi na e përmendi që në bisedën e parë. Para këtij takimi, në kulmin e kinezërive komuniste i kisha pëlqyer sido



mos vargjet: rinia kurrë nuk është treguar më e mençur/se sa atëherë kur nxiton për në takime dashurie...". Shënjon Graçi. Për të, libri i tij "Ku shkoni ju statuja" mu në grahamat e fundit të diktaturës komuniste, ishte për shpirtin balsam; ndërsa poezia si "Kishte celur lulja e lulirit" apo ajo për Pentesilenë, krahas poezisë të tjera të mëvonshme te "Ne, pikëllimi i dritave" apo "Më vjen keq për Jagon" janë ndër arritjet më

të përkryera të poezisë sonë.

"Rreshtat e mësipërm nuk i hodha vetëm si homazh për ndërprerjen fizike të një jete, por si ngushëllim edhe për veten time. Më ngushëllon fakti se edhe unë e kam njohur si njeri e kam bashkëbiseduar shumë herë me poetin e madh Fatos Arapi. Në takimin më njëshkrimtar tjetër të madh, jo pa dinakëri ai më pati pyetur: "përse ke dashur të takohesh me mua?". E kuptova shpejt shqetësimin e tij e i thashë: "Pavarësisht se jemi shumë larg njëri-tjetrit si moshë, si brezi e si autorë, ne jemi bashkëkohës, njëri është në vendin e të një kohe të paktën prej 30 vitesh. Si lexues i letërsisë shqipe, si ligjërues e studiues i saj unë nuk mund t'ia lejoj vetes in-diferencën, mungesën e kureshtjes për anën njerëzore të çdo shkrimtari të rëndësishëm", e mbyll shënimin e tij, Graçi.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 631

SUPLEMENTI I PERJAVSHEM GAZE TA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela ALIAJ - Art Designer: Nevila Samarzhi

E shtunë 13 Tetor 2018

XHILDA LUZI: Si erdhi propozimi dhe të papriturat e së dieles



**"Zbulimi i Manushit"// Rrëfihet "Miss Durrësi":
Edhe 'miss'-et shëndoshen, kanë celulit dhe nuk
janë perfekte si në fotot në "Instagram"**

**"ZHUKU K'RVË
E DOBËT..."
HABIT BEATRIX
RAMOSAJ, LESHON
GOJËN NDAJ KOMENTUESËS**



FATON SHOSHI: NUK KA FEJESË

*Tantuan ta vrisnin, menaxheri i Ledri Vulës:
Erdhën me maska, dikush ka paguar lekë*



• KAPITAL T ZBULON TË DASHURËN? REAGON VAJZA: UNË KAM NJË TË DASHUR... • BLEONA VISHET ME TË BARDHA, S'MUNGON KOMENTI TIPIK I ERMALIT • ÇIFTI SI TUNA DHE PATRISI, DITËN PRINDËR E NATËN NËN EFEKT ALKOOLI • "NËSE NUK IA KA QEJFI TË..." MENDOHEJ SE ISHTE LIDHUR ME 18-VJEÇAREN, KËNGËTARI THUMBON ME FJALËT

Kapital T zbulon të DASHURËN?

Reagon vajza: Unë kam një të dashur...

Pas publikimit të imazheve të fundit në profilin e tij në 'Instagram', e kuptuam që Kapital T po xhiron klipin e një kënge të re, e cila ka të bëjë me dashurinë. I pozicionuar në një helikopter, reperi u shfaq pranë një vajze të bukur ku edhe po shtrëngonte duart. Fotot që postoi i bënë lëmsh fansat e tij, të cilët filluan aludimet në është vajza në fjalë e dashura apo vetëm një vajzë që



merr pjesë në klipin e reperit. Vajza në fjalë është ish-Miss Mali i Zi dhe quhet Marija Kolinovic, derisa kjo e fundit ka publikuar edhe një seri fotografish me Kapon në 'Instagramin' e saj. Por nga 'Instagrami' i saj duket se është dikush tjetër në jetën e saj kështu që bien poshtë aludimet lidhur me një romancë me reperin e njohur. Ka qenë pikërisht ajo që ka vendosur të sqarojë gjithçka për publikun me anë të një postimi. "Njerëzit kanë folur për lidhjen time me Trim për disa orë tani, kështu që unë po bëj një deklaratë për këtë gjë. Trim është me të vërtetë një djalë perfekt, por lidhja jonë është vetëm e natyrës profesionale. Unë kam një të dashur dhe ai është Petar Abramovic. Kjo është e gjitha që kam për të thënë", ka sqaruar Marija. Pra, ajo është vetëm një vajzë që duket se ka marrë pjesë në projektin më të ri të Capital T, me siguri për baladën që ai ka lajmëruar se do të sjellë.

'E gjithë bota jemi 4!', futbollisti i kombëtares lumturohet sërish me një ENGJËLL

Është bërë baba për herë të dytë futbollisti i njohur i kombëtares, Andi Lila. Pas përfundimit të ndeshjes me Jordaninë, Lila duket se ka marrë leje nga trajneri për të qenë aty kur vogëlushja të vinte në jetë. Ai dhe bashkëshortja e tij Ornela kanë vendosur që vajzën ta quajnë Axa. Lajmin e mirë, futbollisti e ka ndarë me të gjithë pak orë më parë në llogarinë e tij të 'Instagram'-it. "E gjithë bota jemi 4! Mirë se erdhe në jetë Axa Lila!"- shkruan Lila në foton ku shfaqet i lumtur me vajzën e sapoardhur dhe djalin 4-vjeçar Ayan. Urime, tashmë një familje e kompletuar dhe e lumtur!



BLEONA

vishet me të bardha, s'mungon komenti tipik i Ermalit



Ajo është padyshim një nga vajzat më të dashura dhe më të përfolura të medias rozë. Përmes 'Instagramit', Bleona Qereti njoftoi se këtë javë do të publikojë klipin e saj më të ri muzikor, të quajtur "Monster", e përveç kësaj nxorri edhe një foto ku shihet e veshur e gjitha me të bardha. Dhe me linjat e saj perfekte dukej vërtetë bukur! Një postim i tillë u ka pëlqyer shumë fansave, ndërsa Ermal Mamaqi nuk e ka lënë momentin t'i shpëtojë pa një batutë nga ato të tijat. "Për hajër o Zot, kush do të të marrë", i shkruan ai, duke e bërë Bleonën të qeshë duke ia kthyer mesazhin përmes ikonave në 'Instagram'. Të shohim suksesin që do të ketë në klipin e shumëpritur.



"Shiko kush Luan" shkurton

STAFIN?

Largohet nga emisioni këngëtarja e njohur!

Sezoni i dytë i emisionit të argëtimit në Top Channel "Shiko kush Luan" vazhdon me shumë surpriza. Kësaj here bëhet fjalë për një ndryshim që ka ndodhur në program e që pritet të reflektohet në transmetimin e puntatës së tretë, të shtunën e 13 tetorit. Në një video promovuese publikuar në rrjetin social Instagram nga autorja dhe prezantuesja e emisionit, Luana Vjollca, shihet se në një fragment sekonde në emision shfaqet këngëtarja Filloreta Raçi- e njohur si Fifi- teksa këndon pranë bandës muzikore. Ndërkohë që nuk shfaqet në asnjë moment këngëtarja e njohur Marsela Çibukaj, e cila ishte e përzgjedhura e këtij sezoni për të kënduar në momente të ndryshme përgjatë emisionit. Në fakt, këtë sezon ishte nënshkruar një kontratë me këngëtares e njohur shqiptare Marsela Çibukaj, e cila është pjesë e një sërë emisionet që transmetohen në Top dhe nuk dihet nëse Marsela është larguar përfundimisht nga ky emision apo mungesa e saj është thjesht në këtë puntatë. Të shohim nëse është ndonjë 'zënkë' apo vërtetë largim i këngëtares.



Çift si Tuna dhe Patrisi, ditën prindër e natën nën efekt **ALKOOLI**



Pushimet ende s'kanë mbaruar për disa nga vip-at tanë. Pikërisht çifti i njohur i medias rozë, Tuna dhe bashkëshorti i saj Patrisi po kalojnë disa ditë pushimi në një prej resorteve të njohura në Kemer, Turqi. Nëse përgjatë ditës dyshja e njohur janë prindër të devotshëm për djalin e tyre të vogël 1 vjeçar Tianin, mbrëmjeve nuk mund të lënë pas dore njëri-tjetrin. Ka qenë vetë këngëtarja ajo që ka publikuar një video në llogarinë e saj në 'Instagram' ku shihet partneri i saj muzikant duke kërcyer nën efektin e alkoolit ndërsa Tuna shkruan "babi u deh". Në një tjetër video çifti i famshëm i showbizit shqiptar filmohen duke u përqaftuar e puthur, video të cilën ylli i "Chonga" e ka fshirë pak orë pas publikimit. Nuk është hera e parë që Tuna dhe Patrisi publikojnë foto e video teksa shkëmbejnë puthje pasionante me njëri-tjetrin duke na kujtuar të gjithëve se dashuria dhe pasioni vazhdon të jetë i njëjtë si në fillimet e lidhjes së tyre edhe pse më pas bëhen prindër. Të veçantë në llojin e tyre.




"Si Boni dhe Clyde" thyejnë rrjetin! Ja cili është çifti më i kërkuar nga shqiptarët në **YOUTUBE**

Kënga e famshme e tyre theu rrjetin me miliona klikime në Youtube, "Bonnie and Clyde". Mozzik dhe Loredana Zefi, të lidhur prej kohësh e në pritje të fëmijës së tyre të parë, janë çifti më i komentuar i ditëve të fundit. Dyshja po ashtu, kanë marrë pëlqimin e publikut derisa në të dhënat e Google, figuron se ata janë edhe njerëzit më të kërkuar nga shqiptarët gjatë muajit të fundit. Kjo vlen vetëm për Youtube, dhe me analizat e Google që Prive ka nxjerrë aty figuron emri i Loredanës dhe Mozzikut, e kjo i bën ata çiftin më të kërkuar të ditëve të fundit. Një Bonnie dhe Clyde shqiptar që u ka tërhequr jo pak vëmendjen fansave të tyre. Duhet bërë një tjetër bashkëpunim!

MENDOHEJ


se s'flisnin me Luanën, Fifi u mbyll gojën 'fake news' me reagimin e saj

Këtë sezon u kuptua se nuk do të ishte më këngëtarja e njohur, Filloreta Raçi e quajtur ndryshe Fifi, në emisionin argëtues "Shiko kush luan".



Dhe për më tepër, sipas thashethemeve thuhej se Fifi ishte zënë me moderatoren shqiptare, Luana Vjollca. Por kjo e fundit u ka dhënë fund thashethemeve duke

postuar një video ku shfaqej këngëtarja e ftuar në episodin e radhës. Nuk u mjaftuan me kaq, por edhe Fifi ka reaguar publikisht për këto aludime dhe tha se e vetmja arsye përse ishte larguar nga televizioni, ishte mbarimi i kontratës. Për t'u dhënë fund të gjitha këtyre fjalëve, Luana Vjollca ka ftuar këngëtarën në episodin e radhës të emisionit të saj "Shiko kush luan". Në promon e emisionit, Fifi shfaqet në skenë duke kënduar. Ja që 'krisma s'ka pasur'. Shumë zhurmë për asgjë si gjithmonë!



"Nëse nuk ia ka qefji të...", mendohej se ishte lidhur me 18-vjeçaren, këngëtari thumbon me

FJALËT



Ai është padyshim një prej reperëve më të përfolur shqiptarë jo vetëm për hitet që prodhon për adhuruesit e muzikës por edhe për sa i përket jetës private. Majk është babai i një djali të vogël, ndërsa ish-dashura e tij, Majlinda, e akuzonte shpesh se nuk ishte një baba i përkushtuar, kjo edhe për shkak të karrierës së tij. Ndërsa kohët e fundit reperi u përfol për një lidhje me 18-vjeçaren Kejda, por që gjithçka u mohua nga kjo e fundit. Në një postim në 'Instagram' Majk shfaqet duke pozuar në makinën e tij dhe foton e ka shoqëruar me një shprehje shumë thumbuese. Reperi shkruan: If she aint fuckin she got to go, tell her don ëaste my time. (Nëse asaj nuk ia ka qefji të q'het më mirë të ikë, thuaji të mos më humbasë kohën". Ende nuk dihet kujt ia ka drejtuar këtë shprehje Majk, i cili shihet në shoqërinë e femrave të ndryshme, por me siguri dikush e ka nxehur për të nxjerrë një postim të tillë.

Shumë surpriza po presim të shohim këtë fundvjeshtë. Po flasim pikërisht për fytyrat e reja, të cilat do t'i shohim shumë shpejt nëpër ekranet e mediave shqiptare. 'Merkato' e vjeshtës ende s'ka përfunduar, duke qenë se shumë personazhe, të njohur apo jo, të vjetër apo të rinj do t'i shohim shumë shpejt si pjesë e pandarë e formateve të ndryshme televizive. Është quajtur si "zbulimi i Manushit" dhe mbase do të jetë me shumë mundësi një nga imazhet më të përfolura dhe të dashura të medias rozë. Ndërkaq, shumë pak dimë për të. Është pikërisht imazhi i ri i emisionit të së dielës në "Top Chanel". Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Xhilda Luzi ka rrëfyer propozimet e emisionit të ri, si u bë pjesë e tij dhe rrugëtimi i saj nga bota e muzikës, modës e tashmë si moderuese në ekran. "Manushi më thotë shpeshherë me shaka që 'ti do jesh zbulimi im televiziv' dhe më besoni, nuk e thotë për faktin që kam qenë miss". Këto dhe më shumë në intervistën e mëposhtme.

Pamela Aliaj

Para disa vitesh keni marrë pjesë në një konkurs bukurie në Durrës, ku edhe keni fituar çmim të parë. Tani sërish riktheheni në një tjetër format. Për çfarë bëhet fjalë konkretisht?

Kur fitova "Miss Durrësin 2009" isha vetëm 16 vjeçe. Ka ndodhur krejt rastësisht pjesëmarrja në kompeticion. Në atë kohë ishte akoma tabu pjesëmarrja dhe përzgjedhja e vajzave bëhej në shkollë. Aty më zgjodhën dhe fati deshi që të merrja pjesë dhe të fitoja. Më pas fitova përsëri vendin e parë në "Miss Beauty Alba-



RRËFEHET "Miss Durrësi": Edhe 'miss'-et shëndoshen, kanë celulit dhe nuk janë perfekte si në fotot në "Instagram"

"Zbulimi i Manushit", Xhilda Luzi: Si erdhi propozimi dhe të papriturat e së dielës

nia 2012" dhe këtu u mbyll pjesëmarrja ime me kompeticionet e bukurisë. Mbaroi pa filluar mirë, sepse siç e thashë, ishte rastësia ajo që më bëri të merrja pjesë. Nuk ishte bota ime e ëndrrave.

Si erdhi propozimi? A ishte drejtpërdrejt nga Manushi?

Kisha vendosur t'i rikthehesha televizionit dhe ishim në bisedime për të gjetur një hapësirë ku mund të përshatatesha. Ishte rastësia përsëri që më bashkoi me Manushin. Gjatë "Top Arenës" ku isha e ftuar, Manushi më tha që ne të dy duhet të takohemi për të folur për emisionin e të dielës. Mesa duket, ishte ajo që kërkoni të dy dhe kështu lindi bashkëpunimi. Manushi më thotë shpeshherë me



"Lëre pasionin të të udhëheqë dhe mëso t'u besosh instinkteve të tua"

shaka që "ti do jesh zbulimi im televiziv" dhe më besoni, nuk e thotë për faktin që kam qenë miss. Manushi do të ketë edhe të tjerë bashkëpunëtorë në këtë projekt, secili i veçantë në llojin dhe përmbajtjen vet, për të krijuar me ngjyra të ndryshme tablonë e së dielës.

A keni pasur propozime të tjera në parë?

Nuk është hera e parë që prezantoj. Në televizion kam marrë pjesë që fëmijë, me emisionet e fëmijëve, më pas në emisione rinore. U shkëpu-





ta për të vazhduar studimet dhe për të ndërtuar veten profesionalisht.

Pse zgjodhët "Top Chanel"?

Në fakt, ishte një zgjedhje reciproke dëshire bashkëpunimi. Por, nëse do t'i referohem dëshirës sime, patjetër që do përgjigjesha: "Kush nuk dëshiron të punojë në 'Top'?! 'Top-i it's On Top'! Sidomos kur ti je në hapat e parë të karrierës tënde, nëse bashkëpunon me më të mirët, patjetër që edhe rezultatet që merren janë më të mirat.

Kur nis emisioni?

Në fund të tetorit besoj jemi gati, maksimumi në fillim të muajit nëntor.

A do të ketë të njëjtin emër emisioni i së dielës?

Jo, do jetë të dielën, por nuk do ketë të njëjtin emër dhe format. Vetëm dita është e njëjtë, asgjë tjetër.

Jashtë impenjimit të ekranit, me çfarë merret Xhilda në jetën e përditshme?

Unë kam mbaruar Liceun për violinë, më pas kam studiuar juridik. Kam qenë gjithmonë e tërhequr nga politika dhe kjo më bëri të ndiqja dhe një Akademi Politike. Kam besuar gjithmonë që nëse do të ndryshosh diçka, duhet të jesh

brenda sistemit për ta bërë atë. Aktualisht punoj juristë në një studio ligjore private. Siç e shikoni, jam një miks gjërash që më formojnë mua, përtej Ekrani ka qenë një

Ekrani ka qenë një



ëndërr e Xhildës, apo një shtysë për të promovuar dhe provuar më tej veten?

Ka qenë një dëshirë që u rizgjua tek unë. Ekranit të jep mundësinë të përdorësh fjalën dhe të dëgjohesh. Një pushtet që nëse di ta përdorësh siç duhet, është një shtysë shumë e mirë si trampolinë për të realizuar edhe qëllime të tjera të vetes.

Cili është sekretit për linjat perfekte që keni? Ndiq-

ni ndonjë dietë apo palestër?

Oh... jam shumë larg perfeksionit! As nuk besoj që ekziston. As nuk do ta shes ndonjëherë veten si të fillë. Linjat e mija janë luatur shpeshherë nga dashuria që kam për ëmbëlsirat. Edhe 'miss'-et shëndoshen, kanë celulit dhe nuk janë perfekte si në fotot në "Instagram". Këtë e them për çdo vajzë që ndihet keq nga kjo bota perfeksionit, që lehtësisht shpërmdahet sot. Për të qenë e sinqertë, sa herë e shoh veten keq, i drejtohem dietologes Anila Kalleshi, që është edhe mikja ime dhe më sjell në drejtimin e duhur. Por përtej shakasë, kam filluar të mbaj një regjim për të ngrënë shëndetshëm, më shumë se për t'u dukur bukur. Shëndeti i brendshëm është më i rëndësishëm se paraqitja e jashtme.

Cila është muza në jetën tuaj?

Muza më e mirë për një njeri besoj që është pasioni. Lëre pasionin të të udhëheqë dhe mëso t'u besosh instinkteve të tua...

Po pendesa më e madhe?

Eksperienca është emri që u vëmë gabimeve tona. Pas ç'do gjëje që më ka ndodhur, është më e rëndësishme t'i them vetes çfarë mësova nga kjo që më ndodhi, sesa të pendohem pse ndodhi. Nuk pendohem për asgjë, sepse çfarë më ka ndodhur, kanë krijuar atë që unë jam sot.

Edhe pse keni fituar 'miss'-in, nuk keni një "Instagram" të mbushur me foto e video ku ekspozoni linjat tuaja. Pse një zgjedhje e tillë?

Rrjetet sociale janë si media jote personale, ku ti pasqyrosh veten. Kam zgjedhur që t'i përdorur unë rrjetet sociale dhe jo të më përdorin mua ato. Siç thashë edhe me lartë, unë nuk jam perfekte, as jeta ime jo, aq më pak "Instagram"-i im. Nuk dua të pasqyroj imazhin perfekt sipërfaqësor për veten. Bukuria zgjat vetëm 5 minuta, nëse nuk ke diçka tjetër për të mbajtur gjallë kuriozitetin. Paraqitja



ime nuk është diçka që e kam krijuar unë që të jem krenare, Xhilda si njeri po. Nuk dua të njihem për paraqitjen. Nuk është ajo që vlerësoj tek vetja, edhe pse nuk mund ta mohoj që më ka ndihmuar shumë. E them shpesh që në jetë njerëzit të presin si dukesh, por në fund të përcjellin si ke mendjen. Mendoj që shoqëria jonë është e tejmbushur me imazh, me lakuriqësi, por i mungon përmbajtja. Sikur të investonin edhe tek vetja brendshme aq shumë sa kujdesen për imazhin e jashtëm, do kishim

një shoqëri më të mirë. Personalisht dua të dal përtej imazhit dhe kurrë nuk do e shes imazh për ndjekës më shumë. Bëhu ndryshimi që ti do të shohësh, duke e nisur nga vetja.

Çfarë përfaqëson "e bukura" sipas jush?

E bukura është kudo, mjafton të duash dhe të dish ta shohësh dhe ta krijosh atë. Bukuria është pushtet, është zili, xhelozia, harmoni, mirësi, dashuri. Varet çfarë çmimi zgjedh të marrësh dhe japësh në këmbim të saj.






“Zhduku k*rvë e dobët...” Habit Beatrix Ramosaj, lëshon gojën ndaj komentueses

Bukuroshja Beatrix Ramosaj është një nga vajzat më të përfolura në mediat rozë për shkak të pamjes së saj gjithnjë të kurrar dhe jo vetëm. Jo rrallë këngëtarja është akuzuar edhe për përdorim fotoshopi në fotot që poston në rrjetet sociale, gjë për të cilën ajo nuk ka reaguar. Por me sa duket këtë radhë Beatrix është irrituar nga kritikuesit dhe ua ka kthyer atyre në të njëjtën monedhë. Ajo ka postuar një foto para pasqyrës vetëm me reçipeta dhe me produktet e makeup-it para vetes. Komentuesja i shkruan: Kur ta heqësh makeupin sigurohu që s'ka njerëz rreth teje se mos i tremb. Ajo ja ka kthyer: “Haha zhduku nga faqja ime k*rvë e dobët”. Mesa duket është mbushur kupa për këngëtarën dhe s'ka mundur të mos reagoonte.

Përvjetor i veçantë, aktori i “Portokalli” feston ditëlindjen ashtu si dikur

Florjan Binaj është aktori i shumë roleve në “Portokalli”, ku padyshim të gjithë e njohin me rolin e policit. Ditën e djeshme ai ka festuar ditëlindjen mes miqsh e personash të dashur. Ai mbushi 33 vjeç i rrethuar nga një grup miqsh e kolegë të “Top Albania Radio”. Në postimet e të pranishmëve duket se ky 33 vjetor e ka gjetur aktorin mes argëtimit dhe të qeshurave nën



diçiturën e ftove “Si dikur”, që mblidheshin të gjithë pas punës. Mesa duket impenjimet e shumta i kanë larguar pak miqtë për të mos u bërë pjesë e mbrëmjeve festive të shijuara në të shkuarën. Por nga fotot duket se aktori e ka shijuar në maksimum kohën e kaluar mes njerëzve të dashur.



Mungon dhe pjesa tjetër e Top Albania Radios



Kryeministri vendos, mbyll emisionin e bukuroshes Gea Braha

Pra dy ditësh kryeministri Edi Rama paralajmëroi mediat që brenda 24 orësh të heqin nga transmetimi reklamën e kazinovave dhe ato të basteve sportive. Ky vendim sipas tij është masa e parë për të mbërritur deri në datën 31 dhjetor kur do të pushojnë së funksionuari kazinotë elektronike si dhe pikat e basteve. Mesa duket ky vendim i Ramës prek edhe një prej emisioneve të transmetuara nga Supersport. Bëhet fjalë për emisionin ‘Bar sport Skedina’. Ky emision bazohet tek parashikimet e ndeshjeve, ku të ftuarit japin parashikimet e tyre për rezultatet e ndeshjeve, duke ju referuar kompanisë së lotos, e cila është pjesë e emisionit. Mbetet për t'u parë nëse ky paralajmërim i Ramës, do të çojë në mbylljen e emisionit, i cili këtë sezon drejtohet nga Gea Braha, ish-velina e ‘Fiks Fare’. Do të ketë apo jo fat për ta nisur rrugën e saj si moderatore? Mesa duket nuk ishte në kohën e duhur.

Shfaqet e kuruar deri në detaj, por këngëtarja s’njihej para se të bëhej e famshme

Në Shqipëri nuk mund të themi me plot gojë se kemi një reperë të mirë që mbizotëron tek të tjerat, sepse ka shumë. Një ndër to është edhe e cila korri menjëherë sukses pas këngës së saj të parë “Columbiana” në bashkëpunim me Don Phenom. Ajo hyri bujshëm në treg edhe me disa prodhime të tjera dhe konkurrencën që u hap midis saj dhe disa reperëve të tjera të estradës. Disa nga frazat e përdorura në këngët e saj janë kthyer në trend edhe për rininë. Por si ka qenë ajo më parë në pamjen e saj? Nëse jeni kuriozë të shikoni ndryshimin që ka pësuar këngëtarja nga sot krahasuar me disa vite më parë, në rrjet po qarkullon një foto e saj ku duket tërësisht ndryshe. Nuk dihet nëse reperja ka kryer operacione plastike apo është thjesht efekti i makijazhit që sot e bën të duket më fotozhenike. Me apo pa bisturi? Tayna thotë që jo, si thoni ju?





Prezantohet e dashura e re e këngëtarit, Faton Shoshi: Nuk ka fejesë

Tentuan ta vrisnin, menaxheri i Ledri Vulës: Erdhën me maska, dikush ka paguar lekë

“Dënohet me 1 muaj burg, ja kush mund të jetë shkaku”

Para disa ditësh në media qarkullonte një lajm ku thuhej se menaxheri i njohur i vip-ave, kryesisht i Ledri Vulës, ishte sulmuar keq dhe ishte shtuar në spital. Ndërkaq pamje të tij nuk u publikuan dhe aludimet ishin të shumta. Por në një prononcim ekskluzivisht për “Blue-tooth” të “Gazeta Shqiptare”, Faton Shoshi na ka treguar të vërtetën. Ndërsa më parë aludohej se strumbullari i këtij sulmi mund të ishin edhe debatet e vjetra që Shoshi kishite me Real 1 dhe dj Blunt, tashmë gjithçka u qartësua nga menaxheri i njohur. Për më tepër ndiqni intervistën e mëposhtme.

Pamela Aliaj

Çfarë ndodhi që përfundoi në spital? Kush ju sulmoi dhe pse?

Kanë tentuar të më sulmojnë por s'kanë mundur të më afrohen. Ishin me maska. Më vonë u kapën menjëherë aty në vend të ngjarjes.

Kush tentoi t'ju sulmonte?

Thotë që e ka dërguar dikush, e ka paguar me lekë.

U identifikua?

Jo, akoma po besoj shpejt kemi për ta marrë vesh.

Kush e ka paguar me lekë? U tha arsyeja pse ju sulmoi?

Nuk po e tregon se po ndërton deklaratat.

Si ndodhi?

Sekonda punë ka qenë. Ai ka tentuar të më qëllonte edhe pësoi. 1 muaj e kanë dënuar me burg. Gjykata e ka cilësuar si rast “tentim për vrasje”, por ai thotë që e kanë paguar. Edhe që ka pasur plan të më mbysë po për fat isha me policë në momentin kur ka tentuar të më sulmojë.

Mendonit se ka lidhje me showbizin?



Andej janë të gjitha pistat. Për sa i përket showbizit, të gjithë i kam miq, s'kam asnjë marrëdhënie të keqe me asnjë. Me të gjithë jam mirë.

Po pse me Indeks-online?

Po, lajme nxjerrin. Ju dyshoni për ndonjë? Që ju ka kërcënuar mbase dhe me parë?

Ka të bëjë me ndonjë lajm. Jo, jo. S'më kanë kërcënuar mua, por mbase ndonjë lajm i ka irrituar njerëzit. Sepse unë

nga ana tjetër jam mirë me të gjithë, s'kam probleme me asnjë.


Nuk më thatë nëse dyshoni për ndonjë konkretisht?

S'kam asnjë dyshim për momentin.

Dmth s'ju ka rrahur, tentoi t'ju dhunonte?

Tentoi të më mbyste, por shokët që kisha me vete ndërrynë menjëherë.



Ndërkaq shumë thashethemeve qarkullojnë për këngëtarin dhe të



dashurën e tij të re. Pas daljes së fundit duket se të dy janë shumë të dashuruar dhe shpesh në stori e këngëtarit e shohim pakëz të nxjerrë si imazh. Pyetjes së fundit lidhur me thashethemet për fejesë menaxheri i Ledri Vulës u përgjigj: Jo, jo nuk ka fejesë.

Jo, jo. S'ka të bëjë me showbizin, Por mendoj se të bëjë me median. Me Indeks-online, portalin tim.

Për cilin dyshoni?



Opinion i Ditës

Mësuesi i diplomuar në Oxford dhe shkolla e drejtorëve

Nga Pëllumb Karameta

(vijon nga faqja 1)

1. Konteksti

... "shkolla e drejtorëve". Ai fokusohet në dy ide:

a) "shteti, nga rregullator dhe kontrollor, është kthyer në ekspert, ku përgatit drejtorët e arsimin parauniversitar" çka "ngjan me një super kontroll etatist të profesioneve të ndryshme, i pakuptueshëm dhe i një stili autokrat".

b) "asnjë nga palët politike, nuk arriti dot të krijonte një formë arsimore, e cila të fuste arsimin shqiptar në një logjikë korporate, që të funksiononte sipas parimit kosto-përfitim". Pasi shpjegoi këto ide, ai sugjeroi që "shkolla shtetërore e drejtorëve, është nismë që duhet ndaluar sa më shpejt."

Fillimisht, diçka për kontekstin historik-arsimor në të cilën ka lëvizur shkollimi dhe ideja për drejtorë shkollë të certifikuar.

2. Çfarë na ofron bota?

Shkollimi, gjatë 150 viteve të fundit, u lidh ngushtë me tendencat ekonomiko-shoqërore. Nevoja e ngutshme për shkollim, si pjesë thelbësore e shërbimit publik, në gjysmën e dytë të shekullit 19-të, u plotësua përmes përpjekjeve për përvetësimin nga fëmijët të shkruar-leximit, numërimit dhe aftësive shkencore. E gjithë kjo, si rezultat i presionit që ushtri revolucionin industrial dhe urbanizimi i shpejtë. Tërheqja galopante e prindërve në linjat e prodhimit, nisi t'i kthejë shkollat në agjentë të moralit, të qytetarisë dhe shoqërizimit të gjeneratave të reja.

Në këtë kontekst, organizimi dhe përbajtja e shkollimit përshtati parimin e Tejlorit (Taylor) për prodhimin bazuar në shkencë në doli të produktivitetit. Kjo, në dekadat e para të shekullit të shkruar, kërkoi punëtorë, të cilët të lexonin dhe kuptonin udhëzuesit teknikë dhe të bënin llogaritje të thjeshta. Shkollat e përballën sfidën me sukses dhe arritën që 80-90 % e popullsisë të aftësohej, gjatë një periudhe të relativisht të shkurtër kohe.

Një funksion tjetër thelbësor i shkollës sipas këtij modeli, ishte klasifikimi i individëve për tregje pune gjithnjë e më të specializuara. Merr jetë sistemi i meritokracisë që vendoste se cilët nxënës duhej të merrnin edukim dhe trajnim të mëtejshëm për të përmbushur rolet drejtuese dhe menaxheriale dhe cilët duhej t'u drejtoheshin linjave të prodhimit. Sistemi funksionoi sipas premisë së 10 % drejtues dhe 90 përqind ndjekës.

Klasifikimi arsimor i njerëzve dhe meritokracia u konsideruan nga qeveritë e kohës si mënyrë e



dudur për të shpërblyer inteligjencën dhe për të shmangur korrupsionin.

Fundi i shekullit të 20-të e zhvlerësi menaxhimin tejlorian të prodhimit dhe nevojën për punëtorë që punonin me modele të ngurta të paracaktuara. Mjedisi aktual ekonomik-shoqëror ka formuar nevojën për një model të nxënë të ngritur mbi bazamente të tjera, si: zotërimi i kompetencave themelore kyçe, aftësia për të punuar me të tjerët, për t'u përballuar me sfida të ndryshme, në nivele të ndryshme dhe me disiplina fleksibël, përmirësimi i aftësive të komunikimit, zgjidhje e problemeve dhe vendimmarrje efektive që merren në çastet që kërkohen etj.

Presioni për arritjen e këtyre objektivave po sfidon vetë themelet e drejtimit dhe menaxhimit të shkollës dhe procesin e nxënies. Përmendim teoritë mbi të cilat organizohet dhe funksionon shkolla si institucion, kurrikulën, strategjitë, mënyrat dhe mjetet për të ndihmuar arritjet e nxënësve,

deri rolet e reja të aktorëve (mësuesit, nxënësit dhe të interesuarve). Është e tepërt të themi se, në botën e sotme post-tejloriane dhe në atë të së nesërme, mësuesit dhe drejtuesit kanë nevojë të nxënë vazhdimisht, për t'u përshatur kushteve dhe kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi. Ndjekja verberisht e procedurave të paracaktuara jashtë shkollës, çka, të shumtën e herës, janë arsye e gërryerjes së besimit të publikut për sa e si nxënë e arrijnë fëmijët dhe shkollat, është tashmë e tejkaluar. Studimet e organizatave me prestigj (OCDE, UNESCO ndër to) pohojnë se sukcesi i reformimit të arsimit kushtëzohet fort edhe nga ndryshimi rrënjësor i menaxhimit të shkollës, ku spikatën menaxhimi mbi bazën e shkollës dhe rritja e autonomisë së veprimit të saj, e baraspeshuar me llogaridhënien përmes supervizionit dhe vlerësimit të nxënësve, format e reja të drejtimit dhe partneritetit e nevojshme, mënyrat e vlerësimit të personelit dhe zhvillimi profesio-

al në detyrë, të gjitha këto në funksion të përmirësimit thelbësor të nxënies. Shkollat moderne kërkojnë nga drejtuesit e tyre kompetenca profesionale për përmirësimin e vlerës dhe dobisë së nxënies, menaxhimin efikas të personelit mësues dhe të burimeve financiare e materiale për plotësimin e nevojave; zhvillimin e marrëdhënieve efektive me komunitetet, përmirësimin e etikës së shkollës për kthimin e saj në mjedis miqësor që frymëzon etj.

Ky është konteksti nga kanë marrë jetë e po zhvillohen politika e përvoja të larmishme për të formuar dhe mbështetur drejtorë shkollë profesionistë në vende të ndryshme, dy dekadat e fundit. Të larmishme për statusin që kërkohet për të ushtruar funksionin (të licencuar si profesionist nga agjenci të akredituara, p.sh., ShBA); të trajnuar dhe certifikuar nga agjenci autonome të akredituara (p.sh., Anglia, Sllovenia); të formuar në Universitete dhe të mbështetur nga një agjenci e specializuar në fushë (p.sh., Izraeli) etj.

3. Drejtuesit e shkollave tona Dy vite më parë, një studim i thelluar i MAS-it, që mbështeti sendërtimin e politikës së re për ngritjen e shkollës së drejtorëve, konstatoi se drejtori i shkollës vijon ta identifikojë veten me drejtuesin tradicional pedagogjik edhe pse kuadri ligjor në fuqi i atribuon atij autoritetin për të marrë vendime mbi burimet (njerëzore, financiare dhe materiale); se "drejtuesit, në aspektin e menaxhimit nuk kanë kuptuar zhvendosjen e theksit nga inputi (ndryshe, gjuha e veprimtarive), te

produktet (ndryshe, gjuha e rezultateve)"; se "drejtuesit e shkollës nuk fokusohen mbi nxënësit dhe nxënien, por interesohen vetëm ose kryesisht (shpesh, jo për paafësinë e tyre) për aspekte të tjera të veprimtarisë së shkollës", se "performancat e pakënaqshme ndikohen edhe nga mungesa e njohurive profesionale dhe e përvojës për udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollës". Si përfundim i studimit: "Drejtimi dhe menaxhimi i shkollave mbizotërohen nga koncepte dhe praktika të vjetruara që kanë nevojë për reformim të thellë".

4. Kthim tek idetë

Shteti, nga rregullator dhe kontrollor, është kthyer në super kontroll etatist të profesioneve të ndryshme, të pakuptueshëm dhe me një stili autokrat. Mendoj se ky është ekstrapolim (zgjerim i idesë përtej të provuarës) i pavlerë. Pasi, edhe po të jetë e vërtetë që shteti është ofruar dhe kontrollues për shkollën e drejtorëve, kjo do të ishte e vetmja provë. Asnjë nga profesionet e rregulluara nuk është nën kontrollin etatist.

Shteti ofron ekspertizën për shkollën e drejtorëve. Edhe ky pohim nuk vlen. Sepse, dhe në këtë rast, shteti (MASR) ofronet thjesht si rregullator dhe mbikëqyrës i procesit dhe produktit. Ndërtimi dhe funksionimi i shkollës së drejtorëve është arritje që do të sigurohet nga ndërveprimi i disa aktorëve kyç. Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit (AAFD), ekspertë trajnimi ndërkombëtar dhe universitete shqiptare do të ofrojnë trajnimet për trajnerët dhe drejtuesit e shkollave dhe do të lëshojnë dëshmitë e kualifikimit. Si aktor i tretë, Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA), e cila do të pajisë drejtuesit me certifikatën që kërkon ligji për arsimin parauniversitar.

Arsimi shqiptar dhe parimi kosto-përfitim. Jo pse ky parim nuk funksionon thujtë në pjesën më të madhe të vendeve të tjera, as pse nuk dihet nëse do ishte funksional po të zbatohet në arsim. As edhe pse shumëkush ka provuar se arsimi efikas dhe cilësor i përfituar e kthen koston shumëfish. Por, sepse ky parim, për ne shqiptarët është thjesht një ideal. Si i tillë, ai shpreh (në rastin më të mirë) të përsosurën që ekziston vetëm në imagjinatë dhe orienton përpjekjet për ta jetësuar. Ai, si çdo ideal, ushqen nevojën, forcën e bërshme që nxit veprimet për jetësim. Njëherazi, që të funksionojë në arsim, parimi kërkon bazamente fortësisht të qëndrueshme politike, ekonomike, sociale dhe institucionale. Sot, ato i kanë vetëm vendet demokratike me ekonomi dhe shoqëri të zhvilluara, me arsim dhe kulturë avangarde. Ndaj pyesim: A duhet ndaluar shkolla e drejtorëve, pse koston nuk konsideroan përfitimt?!
Tiranë, më 10. 10. 2018

Dje në "Deutsche Welle"

Gjermani-Jugosllavi, ata që qëndruan një jetë

Nga Martina Martinović

(vijon nga faqja 1)

... atëherë socialiste, të njohur si marrëveshja për "gastarbeiter"-punëtorë të ftuar për një kohë të caktuar. Shumë veta erdhën për një vit, por qëndruan një jetë.

Gardh me gjemba, policia me mitraloza, qen kufiri, vështrime të rrepta dhe uniforma që të kujtonin kampet në Luftën e Dytë Botërore. Këto janë përshypjet e para të Bosiljka Schedlich, atëherë 19-vjeçare, që erdhi si punëtoare e (Gastarbeiter) para 50 vjetësh në Berlin. Aeroplani i solli punëtorët në Berlinin Lindor, pastaj me një autobus ata kaluan kufirin për në Berlinin Perëndimor. Edhe në Berlinin Perëndimor dukeshin plagët e luftës. "I pashë gjurmët e luftës edhe në fytyrat e shumë grave të vetmuara, që dilnin të shëtisnin me qen. I pashë në krahët apo këmbët që mungonin, burra që shtyeshin me karrocën e invalidit dhe pyesja veten - ku kanë qenë ata në luftë", kujton sot 69-vjeçarja.

Edhe në bodrumin e konviktit ku banonte Bosiljka me 1.200 punëtorë të tjerë, banonin gjermanë të debur nga Prusia Lindore. "Për mua ishte një takim me të shkuarën që kishin përjetuar prindërit e mi". Por, Bosiljka kish ardhur për të ardhmen në Gjermani, për të fituar para për studimet. "Erdha për një vit, por ky vit nuk po përfundon kurrë", thotë pensionistja, që ka ardhur të kalojë pushimet në një shtëpi të vogël fshati në ishullin kroat Sipan.

GJYSA E RROGËS PËR KURSIN E GJERMANISHTES

Rinovimi i kësaj shtëpie është për Bosiljkan edhe një "kthim tek rrënjët", sepse dalmatja lindi si Bosiljka Grgurević në Split dhe vendosi pas maturës, si shumë bashkëkombës të vij në Gjermani, kur u hap rruga për Marrëveshjen e Fuqisë Punëtoare me Jugosllavinë. Ajo punoi fillimisht në një fabrikë, për të punuar gjysmë viti më vonë si përkthyes në një konvikt për gratë. Deri në këtë moment historia e saj i ngjason shumë të tjerëve që erdhën si "gastarbeiter". Por pastaj, ajo vendosi të ndjekë një rrugë tjetër. Gjysmën e rrogës e shpenzoi për të mësuar gjermanisht, filloi të gjejë punë më të mira dhe pastaj filloi studimet në Universitetin e Lirë të Berlinit (FU). "Jeta më kishte mbërthyer dhe nuk e mendoja më kthimin".

Shumë nga të ardhurit e tjerë nga Jugosllavia qëndruan në modelin e punëtorit. "Qëllimi i tyre nuk ishte largimi nga Jugosllavia", thotë historiani nga Beogradi, Vladimir Ivanovic, aktualisht studues në Universitetin Humboldt në Berlin, i cili e ka trajtuar nga



ana shkencore temën e punëtorëve të ardhur me marrëveshjen e fuqisë punëtoare në Gjermani. "Qëllimi i tyre ishte të fitonin në kohën më të shkurtër sa më shumë para, me qëllim që të zgjidhnin disa probleme të ekzistencës, probleme banimi, apo për të blerë makineri të caktuara. Disa erdhën vetëm për të blerë një motor, për të shitur mend në shëtitoren e Splitit. Pra, motivet ishin nga më të ndryshmet, por të gjithë erdhën për të punuar për një kohë të caktuar".

FËMIJËT QË QËNDRUAN TEK GJYSHËRIT
Edhe deputeti socialdemokrat, Josip Juratovic e konfirmoi këtë. "Punëtorët që erdhën atëherë në Gjermani, e kuptuan edhe veten si gastarbeiter, pra i ftuar për një kohë të caktuar. Gjenerata e parë mendoj pra të mblidhte ca para dhe të kthehej. Edhe Juratovic vetë është gastarbeiter. Nëna e tij erdhi për të punuar në një fabrikë konservave në Jugosllavi në vitin 1968 dhe e la djalin tek gjyshërit, si

shumë familje të tjera. Pas shkollës, Josip Juratovic erdhi tek nëna në Gjermani dhe filloi shkollën profesionale si mekanik në Heilbronn. Pas 20 vitesh punë filloi edhe karriera si politikan. "Unë erdha si gastarbeiter, u bëra emigrant, dhe sot jam gjerman me sfond migratorin".

Një fjalë që përkrahur fatin e më shumë se 1.5 milionë njerëzve që erdhën nga Jugosllavia në kuadër të Marrëveshjes së Fuqisë Punëtoare me Gjermaninë. Ata u quajtën "Jugot" në Gjermani dhe në vitet '80-të, siç thotë Juratovic e kuptuan se nuk mund të kthehen më, edhe për shkak të fëmijëve, që shkonin në shkollë, flisnin rrjedhshëm gjermanisht dhe që po largoheshin gjithnjë e më shumë nga shoqëria, e cila kishin ardhur prindërit e tyre. "Ky ishte mësimi i parë se nuk ka më kthim pas. E dyta për ish-jugosllavët ishin lufta që shpërtheu në territorin e Jugosllavisë, ku shumë e kuptuan,

JUGOSLLAVËT QË "NUK BININ NË SY"

Jugosllavët ndodheshin para një sfide - integrimi. Shoqëria gjermane ishte e mendimit, se ky grup mjaft punëtor migrantësh ishte i integruar, kishte integruar veten. Sepse kulturalisht ky grup nuk dallonte shumë nga gjermanët, thotë historiani Ivanović, "sepse edhe jugosllavët e hanin mishin me patate, nga ana tjetër është një komunitet që flet gjermanisht, nga pamje nuk duket ndryshe dhe nuk binte në sy në këtë kontekst". "Një integrim në dukje", thotë Bosiljka Schedlich.

Por e vërteta është se shumë jugosllavë qëndronin me njëri-tjetrin më shumë, organizoheshin në klube apo në kisha si "Misioni Kroat Katolik". Për më të moshuarit ishte e vështirë që ta mësonin mirë gjermanishten. Por fëmijët e tyre dhe gjenerata e tretë konsiderohen si të integruar shumë mirë. "Shumica e jugosllavëve i dhanë rëndësi të veçantë që nga fillimi shkollimit të fëmijëve, ashtu si ata ishin punëtorët më të mirë, edhe fëmijët duhet të ishin nxënës më të mirë, ose nxënës shumë të mirë. Gjenerata e re ka kështu një shkollim më të mirë, shumë kanë studiuar. Ata janë ata që jetojnë me vetëdije në Gjermani".

Por shrohet edhe çështja e atdheut. Çfarë është atdheu për gjeneratën e parë, të dytë apo të tretë? Bosiljka Schedlich ka një përgjigje të thjeshtë. Vendlindja e saj, atdheu i saj i parë dhe atdheu gjerman janë një. Bota sot është e ndër-lidhur". Unë jam gerade në Sipan tani në shtëpinë time, por këtu ndjehem edhe në Berlin Frohnau. Nuk mund t'i ndaj këto".

Jugosllavët ndodheshin para një sfide - integrimi. Shoqëria gjermane ishte e mendimit, se ky grup mjaft punëtor migrantësh ishte i integruar, kishte integruar veten. Sepse kulturalisht ky grup nuk dallonte shumë nga gjermanët, thotë historiani Ivanović, "sepse edhe jugosllavët e hanin mishin me patate, nga ana tjetër është një komunitet që flet gjermanisht, nga pamje nuk duket ndryshe dhe nuk binte në sy në këtë kontekst". "Një integrim në dukje", thotë Bosiljka Schedlich.

HOROSKOPI

DASHI

Mosrëhatia mund t'ju prishtë qetësinë, por një miq juaj do t'ju ndihmojë shumë për të zgjidhur problemet. Përpiquni t'i përmbaheni buxheti tuaj dhe mos bëni shpenzime të kota, pasi mund të përballeni me një ngërc financiar. Sot mund t'ju ofrohet puna që gjithnjë keni dëshiruar.

DEMI

Fëmijët do t'ju ndriçojnë ditën. Ka gjasa të merrni një lajm të mirë, i cili nuk do t'ju lumturtojë vetëm ju, por edhe familjen tuaj. Nëse keni ndonjë shqetësim në lidhje me partnerin/partneren tënde, bëni mirë të flisni me të pasi nesër do të jetë vonë.

BINJAKET

Sot mund të irrirohet edhe për çështje të vogla. Nëse keni ndërmend të investoni, mos merrni asnjë vendim pa i shqyrtuar të gjitha opsionet. Tregohuni më të duruar me fëmijët. Shëndeti i bashkëshortit/bashkëshortes tuaj mund t'ju shqetësojë sot.

GAFORJA

Do të ndiheni shumë mirë si fizikisht ashtu edhe nga ana psikologjike. Ka gjasa që sot të kryeni disa shpenzime të tepërta. Do të përjetoni momente shumë të këndshme me partnerin/partneren tuaj. Lodhja juaj në punë do të vlerësohet sot.

LUANI

Disa persona mund të mendojnë se ju nuk jeni në gjendje të ndërmerrni sfida të reja, por kjo nuk është aspak e vërtetë. Mos bëni në pesimizëm. Jepni kurajo vetes dhe shfrytëzoni aftësitë tuaja. Tregohuni sa më origjinal dhe i sinqerët me partnerin/partneren tuaj.

VIRGJERESHA

Parashikohet një ditë shumë e mirë, pasi do të çlirohni nga një sëmundje afatgjatë. Do të keni dëshirë të udhëtoni dhe të shpenzoni para. Mund të shkatërroni planet tuaja nëse tregoni gjithçka rreth tyre. Bashkëshorti/bashkëshortja juaj do të tregohet shumë mbështetës ndaj jush.

PESHORJA

Përpiquni të kontrolloni natyrën tuaj impulsive dhe kokëfortësinë, veçanërisht gjatë një mbrëmjeje që do të organizohet mes miqve. Fëmijët do të bëjnë të pamundurën për t'ju bërë të lumtur. Gatishmëria për të ndihmuar personat në nevojë, do t'ju shpërblehet me respekt.

AKREPI

Bëni kujdes tek sa ngjisi makinën, sidomos gjatë kthesave. Neglizhenca e dikujt mund t'ju shkaktojë probleme. Përgjegjësitë familjare do t'ju rriten, çfarë do t'ju shkaktojë tension. Në punë, gjërat do t'ju shkojnë ashtu siç ju dëshironi.

SHIGJETARI

Nuk do të ndiheni mirë fizikisht, për shkak të lodhjes së tepërt në punë. Do të kaloni një ditë të komplikuar me partnerin/partneren tuaj. Do të zhgënjeheni, pasi nuk do të merrni vlerësimin që prisnit në punë.

BRICJAPI

Presioni nga shefat në punë do t'ju shkaktojë tension. Kjo do të ndikojë edhe në përqendrimin tuaj në punë. Familjarët do të tregohen shumë mbështetës ndaj jush. Mos ndërmerrni vendime të nxitura, pasi ka gjasa të pendoheni shumë shpejt.

UJORI

Të ardhurat financiare nuk do të jenë ato që prisnit. Ka gjasa që të takoni një person, të cilin keni shumë vite pa e parë. Bashkëshorti/bashkëshortja juaj mund t'ju lëndojë sot, çfarë do të jetë motivi për t'u ndjerë të mërziut gjatë gjithë ditës.

PESHQIT

Mbështetja e miqve do t'ju bëjë të ndiheni të lumtur. Anëtarët e familjes suaj do të tregohen shumë kërkues ndaj jush. Partneri/partnerja juaj do të shfaqë disa këndvështrime krejtësisht ndryshe nga ju, çfarë do t'ju habisë

Tirana zyrtarizon largimin e trajnerit brazilian. Presidenti bardheblu shpjegon arsyet

Halili: Nuk do të lejoj që formacionin ta bëjnë gazetaret

Ze Maria: Divorci ishte i pashmangshëm

Jeton Selimi

Lajmi i qarkulluar në media prej dy javësh në lidhje me largimin e Ze Marias është zyrtarizuar dje nga klubi bardheblu. Presidenti Refik Halili dhe trajneri Ze Maria kanë dalë në konferencë për shtyp para mediave, për të zyrtarizuar largimin e brazilianit. Si fillim, ka qenë vetë presidenti Halili, ai i cili ka treguar edhe arsyen e konferencës, duke njoftuar se marrëveshja me Ze Marian është mbyllur, ndërkohë që më pas i ka lënë fjalën trajnerit Ze Maria. "Zyrtarisht i japim fund marrëveshjes që kemi bërë në fillim, në po këtë vend me Ze Marian", u shpreh Halili. "Rezultatet na detyrojnë që ta ndërpresim këtë bashkëpunim me shumë keqardhje. Tani do ta nisim nga fillimi përsëri. Për sa i përket çështjes financiare, kemi thënë fjalët tona dhe e kemi mbyllur për 5 minuta. Këtë nuk e bën asnjë. E bëri vetëm Ze Maria. Nesër do ua jap dhe dokumentet dhe të shikoni që këto gjëra janë të pastra dhe kështu siç thashë unë. Nuk e ka bërë kush, përveçse Ze Marias. Jam shumë i kënaqur dhe e falënderoj. Për emrin që ky ka, jam i bindur se do të ecë. Kam qenë shumë i kujdesshëm, se Ze Maria është një person i njohur në futboll. Sa herë që dalim nga një rezultat që ne humbim, ka gazetarë që më pyesin për tifozët. Si tifozët tanë nuk ka në Shqipëri. Kam qenë shumë i kujdesshëm dhe nuk kam thënë ndonjëherë se tifozët janë të këqij. Nën drejtimin tim janë larguar 7 trajnerë. Megjithatë, arsyetojini si të doni. Largimi i trajnerëve është vetëm për rezultatet. Ka ikur Ilir Daja dhe Mirel Josa. A nuk mund të pyetet Josa, Daja a ndërhyu Halili në formacion. Mund të pyesni dhe Ze Marian. Nga sot e tutje do të ndërhyj, meqë s'kam ndërhyrë. Jo se do të bëj formacionin, por do të jem shumë i kënaqur. Nuk do ta lejoj që formacionin ta bëjnë gazetarët. Dëgjojmë llafe në Shqipëri. Unë kam dëgjuar në shumë studio, nëse do ta ngre edhe unë zërin, nuk do të ketë ndonjë fryt të Tiranës. Nuk flasim për arbitra, nuk ngacmojmë askënd, por në përgjithësi ne që po rrimë urtë, po e pësojmë. Kur u ngrën zërin, edhe juve kur ju kërcënojnë, rrinë pincë, nuk flasin. Ndërsa kur vjen puna të Tiranës, flasin çfarë të doni. Ka trajnerë që bëjnë 2-3 gazetarë për vetë dhe ua bëjnë ata formacionin".

Më pas, vijon fjalimi i Ze Marias. "E mbyllim sikurse e nisëm. Një vit e 6 muaj më parë, u gëndëm në të njëjtin vend. Eshhtë e drejtë që të largohem duke folur për të gjithë gazetarët. Dua t'i falënderoj të gjithë, klubin



dhe gazetarët për gjithçka kemi kaluar. Ka qenë një periudhë rritjeje për mua si profesionalisht, ashtu edhe në aspektin personal. Kam takuar njerëz që e duan këtë

klub dhe unë jam i lumtur që kam qenë pjesë e këtij klubi. Kur martesat nuk shkojnë mirë, divorci është i pashmangshëm, për arsye të rezultateve negative. Eshhtë e drejtë që trajneri të shkarkohet dhe kur arrihet marrëveshja mes palëve, kjo është më mirë për të gjithë. Një falënderim të veçantë e kam për tifozët, për faktin se pata kohën për t'i gëzuar. Sezonin e kaluar ishin shumë të mërzhitur me skuadrën. Kam parë që kanë pasion për këtë skuadër. Shpresoj të shihemi në të ardhmen, nuk e di ku. Shpresoj të kem lënë shenjë të mirë këtu në Shqipëri".



Timonier, një i familjes "bardheblu"

Mema lë Flamurtarin, gati stoli Tiranës

Ditën e djeshme, trajneri Ze Maria është larguar zyrtarisht nga drejtimi i Tiranës dhe po dje është emëruar edhe trajneri i ri i bardhebluve. Ardian Mema do të nisë aventurën e tij në krye të stolit bardheblu, duke i dhënë fund në këtë mënyrë bashkëpunimit me Flamurtarin si zv.trajner. Lajmi për largimin e Memës u konfirmua nga vetë faqja zyrtare e Flamurtarit në "Facebook", ndërkohë që prezantimi i tij si trajner i Tiranës pritet të bëhet gjatë orëve në vazhdim. Ka qenë vetë Mema, ai i cili ka kërkuar që të largohet nga kuqezinjtë për të marrë drejtimin e bardhebluve, gjë të cilën kryesia e klubit e ka miratuar. "Klubi njofton mbylljen e bashkëpunimit me trajnerin e dytë Ardian Mema. 'Flamurtari Football Club' dhe Ardian Mema kanë vendosur të ndërpresin me mirëkuptim marrëveshjen mes palëve. Duke e falënderuar për bashkëpunimin, 'Flamurtari F.C.' i uron suksese në karrierën e tij si trajner", shkruhej në njoftimin e klubit.

HIJE SKANDALI NË CHAMPIONS

PSG-Zvezda e trukuar? UEFA nis hetimet



Ditën e djeshme media franceze "L'Equipe" ka nxjerrë një lajm tronditës për futbollin, nëse ai do të vërtetohet. Siç bën me dije gazeta më e madhe sportive franceze, UEFA ka lëshuar një alarm tek autoritetet transalpina për një fiksimit të mundshëm të rezultatit, në ndeshjen e xhiros së dytë në Ligën e Kampioneve, mes PSG dhe Crvena Zvezda, e mbyllur me shifrat 6-1 një favor të parizienëve. Siç raportohet, për ndeshjen e luajtur më datë 3 tetor, një informator ka lajmëruar UEFA-n se drejtues të klubit serb, por edhe disa bashkëpunëtorë të tyre, do vinin bast rreth 5 mln euro për humbjen e Crvenës, me të paktën 5 gola diferencë. Autoritetet kanë nisur hetimet dhe të reja priten, por nëse vërtetohet, kjo do të ishte një njohtë e madhe për kompeticionin më të rëndësishëm europian.

Largohen Ramadani e Veseli të dëmtuar

Berisha dhe Grezda, në një linjë: Fitojmë në Izrael

Portieri Etrit Berisha dhe sulmuesi Eros Grezda dolën dje përpara mediave në vigjilje të ndeshjes zyrtare eliminatorë të së dielës në Ber Sheva me Izraelin. Sipas futbollistëve, angazhimi është maksimal për të marrë fitoren të dielën në mbremje. Portieri Berisha për këtë takim theksoi: "Një ndeshje, e cila është vlerësuar maksimalisht nga ana jonë. Tashmë jemi me pikë të barabarta të tria skuadrat në grup. Klima në ekip është shumë e mirë dhe të gjithë bashkë do shkojmë për të marrë fitoren. Mundësitë ekzistojnë për të dalë me rezultat pozitiv pasnesër

(nesër). Nisur edhe nga humbja e Skociës, nëse marrim rezultat pozitiv të dielën në Izrael, atëherë transferta që humbëm në Skoci pak do të vlejë. Tentojmë fitoren, por të them të drejtën, edhe barazimi nuk do të ishte i keq", - citoi portieri Berisha. "Nuk është aspak e pamundur. Janë një kundërshtar i fortë, por edhe ne kemi forcën tonë. Njohim lojën e tyre, nisur edhe nga fitorja karshi tyre një muaj më parë në Elbasan. Na pret një 90-minutësh shumë i vështirë, por me përqendrimin e duhur do ia dalim për të arritur një rezultat pozitiv", - theksoi Berisha. Ndërkaq, Grezda

ka besim maksimal që skuadra do të reagojë në mënyrën më të fortë të mundshme të dielën në mbremje për të marrë fitoren: "Jemi në një moment, ku fitorja do të ishte një shtysë shumë e madhe për ekipin. Kemi punuar dhe do të vijojmë të punojmë shumë në seancat e ardhshme për të arritur objektivin tonë. Kam besim që mund t'ia dalim, edhe pse kundërshtari ka pikat e tij e të forta, me të cilat na vuri në vështirësi edhe në takimin e parë në Elbasan. Mendoj që jemi tri skuadra shumë afër njëra-tjetrës, në një kohë që edhe Izraeli ka pika të forta dhe kërkon shumë përqendrim e an-




gazhim. Nga fitorja në Turqi mungojnë vetëm Sadiku e Roshi. Të tjerët janë po ata. Por e them me bindje që, Nëse përsërisim ndeshjen e Turqisë, nuk na ndal dot as Izraeli e as Skocia".

Ekipi kombëtar do të vijojë stërvitjen e tij sot para dite përpara nisjes. Skua-

drës, siç edhe është raportuar më parë, i janë larguar Veseli e Ramadani dhe në vend të tyre, trajneri ka grumbulluar Ivan Balliu dhe Sabien Lilajn. Ndeshja do të luhet ditën e diel në orën 20.45 në Ber Sheva dhe do të gjykohej nga arbitri italian, Paolo Mazzoleni.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një dite në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimim.
23. Pak elementarë
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrahina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.
37. Janë legjendat.

38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penjtë për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimeeve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa gift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pështjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në litar.
46. Fillojnë lejen.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë iustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.

VERTIKAL


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hiden të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllën me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullimann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	2	7						6
1	3							
			4		5	1		
9				8				
		6	3		1	5		
				9				8
		1	8		2			
							2	9
5						7	3	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	1	5	9	2	6	8	4	7
6	2	7	3	4	8	5	9	1
8	9	4	1	7	5	2	6	3
2	3	6	4	1	7	9	8	5
9	7	8	5	6	2	3	1	4
4	5	1	8	9	3	6	7	2
5	4	9	2	8	1	7	3	6
1	6	2	7	3	9	4	5	8
7	8	3	6	5	4	1	2	9

Argëtim filozofik

Nëse e bën një femër të buzëqeshë, gjithmonë ke vend në zemrën e saj...

Forca shpirtërore s'është gjë tjetër, veçse arti për të mbajtur mbyllur në zemër shqetësimin

Nuk ka ilaç që mund të shërojë atë që nuk shëron dot lumturia...!!

"Kurrë më!" -Thoshte vullneti i lodhur...
"Edhe një herë..." -Lutej zemra duke rënkuar...

Thënie të mençura

- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta
- Më pëlqente. Dukej një tip interesant derisa filloi të flasë... Çfarë mallkimi!
- Jeta është ZOO në një xhungel.
- Peter De Vries
- Jeta është një semundje që përhapet përmes marrëdhënieve seksuale...

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	U	L	T	14	4	9	7	4	19
8	10	5	1	4	12	2	6	7	5
10	4	7	4	1	2	8	10	6	4
18			1	7	5	8	9	4	2
6	5	1	6	2	10	5	2	5	12
7	1	17	5	1	5	10	17	4	2
2	5	10	17	4	2	4	10	6	15
8	2	8	12	15	6	10	17	5	
18	10	5	16	19	6	4	8	10	1
6	7	5	6	11	5	9	19	6	7
4	11	4	7	6	2	6	1	5	7
12	5	2	5	12	1	6	15	4	2

M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K
E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A	
I	T	E	A	T	E	R	M	I	N		
E	R	A	P	O	L	A	R	T	A		
K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T
L	P	O	L	I	G	A	M	I			
E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
T	R	I	S	E	T	M	N	U	N		
I	T	T	U	T	U	I	T	I	D		
K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E	
E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR

P	E	T	R	I	K	A	S	P	A	K	
T	R	U	P	I	A	L	E	N	T	I	A
B	E	L	S	A	N	D	O	X	A	N	A
B	A	K	U	N	I	N	A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	I	H		
P	I	E	E	N	A	O	D	R	E		
A	C	T	O	N	E	K	K	A	O	S	
R	A	T	R	A	D	E	A	L	M	A	
K	E	M	A	P	E	T	E	E	A	P	
E	L	S	A	N	A	L	R	O	N	E	
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T
M	A	B	U	S	E	H	A	N	E	T	
O	R	E	S	S	B	D	E	M	O	N	I
R	A	S	T	K	A	B	I	T	E	R	I
I	B	A	P	E	R	I	T	O	N	I	T
A	I	K	I	M	B	O	I	R	K		
R	A	S	A	P	A	G	A	N	I	N	I
T	A	V	E	R	R	A	N	D	O	M	
Y	M	A	R	S	I	F	O	R	M	A	
H	A	R	K	A	T	I	R	E	R	I	T
A	S	T	I	R	A	D	A	M	E	S	
S	H	A	M	A	T	A	L	O	T	U	S

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



